

TELEKOM ALBANIA Sh.A.

PASQYRAT FINANCIARE
SIPAS STANDARDEVE NDËRKOMBETARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR
PËR VITIN USHTRIMOR TË MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2019

Tabela e përmbajtjes

Raporti i Audituesit të pavarur	i
Pasqyrat financiare	
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.....	1
Pasqyra e pozicionit financiar.....	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital.....	3
Pasqyra e lëvizjeve të mjeteve monetare	4
Shënime shpjeguese të pasqyrave financiare	
1. Historiku i Shoqërisë.....	5
2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël.....	5
3. Vlerësime të rëndësishme të kontabilitetit dhe gjykime në zbatimin e politikave kontabël.....	17
4. Zbatimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara	19
5. Standardet e reja kontabël	20
6. Të ardhura nga kontratat me klientët.....	21
7. Kosto e shitjeve	21
8. Shpenzimet e përgjithshme, të shitjes dhe administrative	22
9. Shpenzime të tjera operative.....	22
10. Shpenzime të tjera.....	22
11. Shpenzime tatim fitimi	22
12. Aktivët afatgjata materiale	25
13. Aktivët me të drejta përdorimi dhe detyrimet e qirasë.....	27
14. Aktivë afatgjata jo materiale	28
15. Inventari.....	28
16. Llogaritë e arkëtueshme	29
17. Aktivë të tjera.....	32
18. Mjete monetare.....	32
19. Kapitali aksionar	32
20. Rezervat	33
21. Dividend për t'u paguar	33
22. Detyrimet kontraktuale.....	34
23. Provigjione.....	35
24. Llogaritë e pagueshme	35
25. Shpenzime të përlogaritura dhe detyrime të tjera afatshkurtra	36
26. Rakordimi i detyrimeve nga aktivitetet financuese.....	36
27. Menaxhimi i rrezikut financiar	37
28. Menaxhimi i kapitalit	41
29. Vlera e drejtë	41
30. Balanca dhe transaksione me palët e lidhura.....	43
31. Angazhime dhe aktive / detyrime të kushtëzuara	48
32. Ngjarje pas datës së raportimit.....	49
33. Politika kontabël përpara dates 1 janar 2019	50



Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerëve të Telekom Albania SH.A.

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Telekom Albania SH.A. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2019, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar:

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019;
- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2019;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera përfshijnë Raportin e drejtimit të brendshëm dhe Raportin e ecurisë së veprimtarisë të cilët priten të vihen në dispozicion për ne pas datës së raportit tonë (por që nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit).

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjerat dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Ndërkohë, janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.

PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.
Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al

Kur ne të lexojmë informacionet e tjera, nëse ne arrijmë në përfundimin se në to gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar t'ia komunikojmë këto çështje personave të ngarkuar me qeverisje.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuideojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një prirshmëri e arsyeshme që të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrembërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.



- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontrolleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

PricewaterhouseCoopers Audit Sh.p.k.

PricewaterhouseCoopers Audit SH.P.K.

7 maj 2020

Tiranë, Shqipëri

Auditues Ligjor
Jonid Lamllari






TELEKOM ALBANIA SH.A.

PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

(në mijë lekë)

	Shënim	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Të ardhura nga kontratat me klientët	6	8,466,430	8,798,797
Kosto e shitjeve	7	(5,158,980)	(5,974,009)
Fitimi Bruto		3,307,450	2,824,788
Shpenzimet e përgjithshme, të shitjes dhe administrative	8	(2,838,027)	(3,147,816)
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	16	(206,455)	(18,967)
Shpenzime të tjera operative	9	(50,758)	(832,997)
Fitimi/ (humbja) operative		212,210	(1,174,992)
Shpenzime të tjera	10	(487,516)	(22,269)
Të ardhura nga interesat		386,501	508,115
Shpenzime financiare		(106,194)	(18,908)
Fitimi nga kursi i këmbimit		278,833	373,131
Humbje nga kursi i këmbimit		(100,853)	(4,385,814)
Fitimi/(humbja) para tatimit		182,981	(4,720,737)
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	11	85,645	-
Fitimi/(humbja) e vitit		268,626	(4,720,737)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse <i>Zëra të cilët nuk do të rriklasifikohen në fitim ose humbje:</i>			
Rivlerësimi i aktiveve afatgjata materiale	20	1,030,280	-
Tatimi mbi fitimin i njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	20	(138,593)	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		891,687	-
Totali i të ardhurave,(humbjeve) gjithëpërfshirëse për periudhën		1,160,313	(4,720,737)



TELEKOM ALBANIA SH.A.

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

(në mijë lekë)

	Shënim	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Aktivët			
Aktive afatgjata materiale	12	7,406,507	5,827,401
Aktive me të drejtë përdorimi	13	946,059	-
Aktive afatgjata jomateriale	14	4,948,480	3,947,258
Investime në letra me vlerë	30	-	14,303,530
Të arkëtueshme nga qiraja financiare		11,778	-
Aktive të tjera afatgjata	17	148,500	176,368
Totali i aktiveve afatgjata		13,461,324	24,254,557
Inventari	15	82,504	75,274
Llogari të arkëtueshme	16	753,910	1,498,694
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	28	41,882	264,867
Investime në letra me vlerë	28	-	27,973,499
Tatim fitimi i arkëtueshëm	11	228,339	228,379
Aktive të tjera afatshkurtra	17	201,203	828,979
Të arkëtueshme nga qiraja financiare		22,548	-
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	18	1,901,014	11,490,839
Totali i aktiveve afatshkurtra		3,231,400	42,360,531
Totali i aktiveve		16,692,724	66,615,088
Kapitali			
Kapitali aksionar	19	813,822	813,822
Primi i aksioneve		-	16,218
Rezerva	20	973,069	23,677,017
Fitimi i pashpërndarë		8,353,120	36,387,267
Totali i kapitalit		10,140,011	60,894,324
Detyrime			
Detyrime kontraktuale	22	116,023	124,917
Detyrime nga qiratë	14	786,461	-
Detyrimi i tatimit të shtyrë	11	52,948	-
Provizjione	23	597,515	198,931
Totali i detyrimeve afatgjata		1,552,947	323,848
Llogaritë e pagueshme	24	3,848,238	3,794,980
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura	28	100	861,463
Detyrime kontraktuale	22	120,399	143,748
Detyrime nga qiratë	14	250,739	-
Detyrime nga qiraja financiare		-	3,803
Dividend për tu paguar	21	9,465	261
Të tjera të pagueshme	25	770,825	592,661
Totali i detyrimeve afatshkurtra		4,999,766	5,396,916
Totali i detyrimeve		6,552,713	5,720,764
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		16,692,724	66,615,088

Këto pasqyra financiare u aprovuan nga Bordi Drejtues i Telekom Albania SH.A. dhe janë firmosur në emër të tij më 30.04.2020 nga:

Emil Georgakiev
Drejtor Ekzekutiv



Borislav Borisov
Drejtor Financiar



TELEKOM ALBANIA SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

(në mijë lekë)

	Kapitali aksionar	Primi i aksioneve	Rezerva	Tepricë rivlerësimi	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Më 1 Janar 2018	813,822	15,777	23,677,017		44,237,462	68,744,078
Efekti i aplikimit i standardeve të reja ose të rishikuara	-	-	-		20,042	20,042
Më 1 Janar 2018 sipas rregullimit	813,822	15,777	23,677,017		44,257,504	68,764,120
Humbja e vitit	-	-	-		(4,720,737)	(4,720,737)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit					(4,720,737)	(4,720,737)
Dividend i paguar	-	-	-		(3,149,500)	(3,149,500)
Opsione për aksione	-	441	-		-	441
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	813,822	16,218	23,677,017		36,387,267	60,894,324
Më 31 Dhjetor 2018 sipas raportimit të mëparshëm	813,822	16,218	23,677,017		36,387,267	60,894,324
Rregullimi i gabimeve nga periudhat e mëparshme	-	-	-		(130,845)	(130,845)
Më 1 Janar 2019 sipas rregullimit	813,822	16,218	23,677,017		36,256,422	60,763,479
Fitimi i vitit	-	-	-		268,626	268,626
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	-	-	-	891,687	-	891,687
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit				891,687	268,626	1,160,313
Dividend i paguar	-	-	(23,595,635)	-	(28,188,146)	(51,783,781)
Opsione për aksione	-	(16,218)	-	-	16,218	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	813,822	-	81,382	891,687	8,353,120	10,140,011

TELEKOM ALBANIA SH.A.
PASQYRA E LËVIZJEVE TË MJETEVE MONETARE

(në mijë lekë)

	Shënim	Viti i imbyllur 31 Dhjetor 2019	Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2018
Flukset monetare nga veprimtaria e shfrytëzimit			
Fitimi neto para tatimit		182,981	(4,720,737)
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimi	12,13,14	2,387,001	1,640,611
Humbja nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale		42,873	182
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	16	214,888	(17,659)
Kthimi nga zhvlerësimi nga AAM		(191,607)	
Kthimi i humbjeve nga zhvlerësimi		(9,624)	(846)
Të ardhura financiare neto		(475,841)	(473,896)
Humbje të përealizuara nga kursi i këmbimit në të tjera përveç mjeteve monetare dhe ekuivalentë të tyre		29,623	769,718
Fitime të realizuara nga arkëtimi i aktiveve financiare		(284,196)	2,285,750
Kompensime të tatimit mbi fitimin		-	582,084
Pagesat e bazuara në aksione të shlyeshme nëpërmjet kapitalit		-	441
Fitimi operativ para ndryshimeve në kapitalin punues		1,896,098	65,648
Rënie në llogaritë e arkëtueshme		483,589	855,189
Rënie/(ritje) në të arkëtueshmet nga palët e lidhura		230,843	(11,864,925)
Rritje/(Rënie) në inventar		(7,231)	277,282
Rënie në aktive të tjera		81,008	12,360,709
Rënie në të pagueshmet ndaj palëve të lidhura		(861,363)	(164,755)
Rënie në llogaritë e pagueshme		(623,553)	(1,277,885)
Rënie në detyrimet kontraktuale		(32,244)	(178,822)
Rritje në detyrimet e përlogaritura e të tjera		43,061	213,428
Mjete monetare të krijuara nga veprimtaria e shfrytëzimit		1,210,208	285,869
Interesi i paguar		(76,207)	(22,826)
Mjete monetare nga veprimtaria e shfrytëzimit, neto		1,134,001	263,043
Flukse monetare nga veprimtaria e investimit			
Blerjet e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	12,13,14	(2,226,033)	(1,577,347)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		5,890	5,890
Interesa të arkëtuar		528,325	577,763
Blerja e letrave me vlerë të borxhit	28	-	(77,974,240)
Huatë ndaj palëve të lidhura		(2,049,165)	-
Arkëtime nga letrat me vlerë të borxhit	28	42,194,460	50,015,550
Arkëtime nga qiraja financiare		45,188	-
Mjete monetare nga veprimtaria e investimit, neto		38,498,465	(28,952,384)
Flukse monetare nga aktivitetet financiare			
Dividend i paguar		(49,354,999)	(3,149,500)
Arkëtime nga huatë	28	430,325	-
Pagesa principlali të detyrimeve të qirasë		(297,617)	(7,076)
Mjete monetare nga veprimtaria financiare,neto		(49,222,291)	(3,156,576)
Ulja neto në mjetet monetare		(9,589,825)	(31,845,917)
Mjetet monetare më 1 janar		11,490,839	43,336,756
Mjetet monetare më 31 dhjetor	18	1,901,014	11,490,839

Shënimet në faqet 5 deri 50 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Historiku i Shoqërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR) për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 për Telekom Albania SH.A. ("Shoqëria").

Shoqëria u themelua si një shoqëri me kapital aksionar më 22 Nëntor 1995, nën emrin Albanian Mobile Communications SH.A. Është e regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare në bazë të vendimit nr. 12910 të Gjykatës së Rrethit të Tiranës dhe në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me numrin unik të identifikimit të subjektit J61814094W.

Bazuar në vendimin e datës 22 Prill 2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionerëve të Shoqërisë, në 7 Maj 2019 u krye kalimi i pronësisë së 99.9% të aksioneve të Shoqërisë nga Cosmote Telecommunications SA të Albanian Telecom Invest AD. Rrjedhimisht, shoqëria mëmë e Shoqërisë është Albanian Telecom Invest AD, zyrat qendrore të së cilës janë në shtetin e Bullgarisë. Aksionerët e Shoqërisë janë Z. Spas Rusev i cili zotëron 65% të aksioneve, dhe Z. Elvin Guri me 35%. Z. Spas Rusev është pala kontrolluese përfundimtare e grupit. Zotërimi i 0.1% të aksioneve është nga aksionerët e pakicës.

Aktiviteti kryesor: Shoqëria është një operator telekomunikimi i përqendruar në ofrimin e telefonisë celulare (lëvizëse). Aktualisht shoqëria zotëron licencat e mëposhtme:

- Autorizimin e përgjithshëm për ofrimin e shërbimeve të Telekomit e cila nuk është e nevojshme të rinovohet;
- Licensën GSM e rinovuar më 1 januar 2015 për një periudhë kohore prej 15 vitesh;
- Licensën 3G për të operuar në rrjetin 2100 GSM, e blerë në 2011 për një periudhë kohore prej 15 vitesh;
- Të drejtën e përdorimit për spektrin e frekuencave 1800 MHz që prej marsit 2015, për 15 vite;
- Të drejtën e përdorimit për spektrin e frekuencave 2500 – 2690 MHz që prej prillit 2015, për 15 vite;
- Spektrin e frekuencave 4 MHz në 900 MHz, 4.5 MHz në 1800 MHz, 5 MHz në 2100 MHz për periudhën kohore të mbetur prej 7 vitesh nga data e raportimit, dhe;
- Të drejtën e përdorimit për spektrin e frekuencave 800 MHz që prej vitit 2019, për 15 vite.

Adresa e regjistruar dhe vendndodhja e Shoqërisë: Adresa e regjistruar dhe vendndodhja kryesore e Shoqërisë është Rruga "Vangjel Noti" Laprakë, Tiranë, Shqipëri.

Monedha raportuese: Këto pasqyra financiare janë paraqitur në monedhën Lek ("ALL"), të rumbullakosura në mijëshen më të afërt, nëse nuk specifikohet ndryshe.

Numri i punonjësve të Shoqërisë në datën 31 Dhjetor 2019 ishte 364 (2018:351)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Politikat kryesore kontabël të zbatuara për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë paraqitur më poshtë. Përveç ndryshimeve të politikave kontabël që rrjedhin nga miratimi i SNRF 16 në fuqi nga 1 Janari 2019, këto politika janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha periudhat e paraqitura, nëse nuk specifikohet ndryshe. Politikat kryesore kontabël të zbatuara për qiratë financiare deri më 31 Dhjetor 2018 paraqiten në Shënimin 31.

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon përdorimin e vlerësimeve të caktuara të politikave. Gjithashtu, kërkon që Drejtimi të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave kontabël të shoqërisë. Fushat që kërkojnë një shkallë më të lartë të gjykimit apo janë më të ndërlikuara, ose fushat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë shpjeguar në Shënimin 3.

Monedha funksionale dhe ajo raportuese

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë dhe monedha e mjedisit ekonomik kryesor në të cilën Shoqëria kryen veprimtarinë e saj.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Transaksionet në monedhë të huaj: Aktivet dhe detyrimet monetare përkthehen në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike sipas kursit të këmbimit në fuqi në fund të periudhës raportuese. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi valutor që rezultojnë nga shlyerja e transaksioneve dhe nga përkthimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare në monedhën funksionale të secilës njësi ekonomike në kurset e këmbimit në fund të vitit njihen në fitim ose humbje si të ardhura ose shpenzime financiare. Përkthimi fund të vitit nuk aplikohet për zërat jo monetarë të matura me kosto historike.

Zërat jo monetarë të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj, duke përfshirë investimet e kapitalit, janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Efektet e ndryshimeve të kursit të këmbimit në zërat jo-monetarë të matur me vlerën e drejtë në monedhë të huaj regjistrohen si pjesë e fitimit ose humbjes së vlerës së drejtë.

Aktivitet afatgjatë materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjatë materiale maten me kosto, minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Programet kompjuterike të blera që janë pjesë përbërëse e funksionalitetit të pajisjeve të lidhura janë kapitalizuar si pjesë e asaj pajisjeje.

Kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, ato llogariten si elemente të ndarë (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjatë materiale.

Ndertesat administrative dhe modernizimi i rrjetit janë subjekt i rivlerësimit të rregullt për të siguruar që vlera kontabël neto nuk ndryshon materialisht nga vlera që do të përcaktohej duke përdorur vlerën e drejtë në fund të periudhës. Rritjet në vlerën kontabël neto si pasojë e rivlerësimit kreditohen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe rritin tepricën e rivlerësimit të kapitalit. Uljet që kompensojnë rritjet e mëparshme për të njejtin aktiv njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse dhe ulin tepricën e rivlerësimit të kapitalit të njohur më herët; të gjitha uljet e tjera njihen në fitimin ose humbjen e vitit. Rezerva e rivlerësimit për ndërtesat administrative dhe modernizimin e rrjetit e përfshirë në kapital transferohet drejtpërdrejt në fitimet e pashpërndara kur teprica e rivlerësimit realizohet për shkak të amortizimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit të aktivitetit.

Drejtimi ka përditësuar vlerën kontabël neto të ndërtesave administrative dhe modernizimit të rrjetit, të matur në përputhje me modelin e rivlerësimit në fund të periudhës raportuese duke përdorur të dhëna të siguruar nga tregu dhe raporton se të dhënat e disponueshme të bazuara në treg për vlerën e drejtë janë të mjaftueshme për të mbështetur përditësimin e kësaj vlere. Drejtimi ka përditësuar vlerën kontabël neto të ndërtesave administrative dhe modernizimit të rrjetit, të matur në përputhje me modelin e rivlerësimit në fund të periudhës raportuese duke përdorur metoden neto.

Kostot e vlerësuar të çmontimit dhe heqjes së një zëri nga aktiveve afatgjatë materiale (detyrimet e aktiveve të dala nga përdorimi) shtohen në koston e zërit, edhe nëse zëri është blerë apo është përdorur gjatë një periudhe të caktuar për qëllime të ndryshme nga prodhimi i inventarëve gjatë kësaj periudhe. Kur ka ndryshime në matjen e një detyrimi ekzistues për daljen jashtë përdorimit të aktivitetit për shkak të ndryshimeve në kohën ose shumën e parashikuar të rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer detyrimin ose nga ndryshimet në normën e skontimit, kostoja e aktivitetit përkatës rregullohet nëse aktivi përkatës matet duke përdorur modelin e koston ose suficitit të rivlerësimit është rregulluar nëse aktivi matet duke përdorur modelin e rivlerësimit. Kostoja e stacioneve bazë të Shoqërisë përfshin gjithashtu një vlerësim të kostove të çmontimit, heqjes dhe rregullimit të vendeve në të cilat ato janë të vendosura.

Kostot e mëpasshme: Kostot e zëvendësimit të një pjese të aktivitetit material afatgjatë kapitalizohen kur, ka mundësi që shoqëria të ketë përfitime të ardhshme ekonomike nga ky aktiv dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Vlera e mbartur e elementëve që zëvendësohen, çregjistrohet. Të gjitha kostot e tjera njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ndodhin.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Amortizimi

Amortizimi përlogaritet duke u bazuar në metodën lineare mbi vlerën e mbetur, përgjatë jetës së dobishme të aktivit. Toka dhe aktivet në ndërtim nuk amortizohen. Jeta e dobishme e aktiveve për periudhën aktuale dhe periudhat krahasuese është si më poshtë:

• Ndërtesa (aktive administrative)	20 vjet
• Ndërtesa të rrjetit	10 vjet
• Instalimet dhe sistemet e telekomunikacionit	5-10 vjet
• Sistemet e përditësuara të rrjetit	7-8 vjet
• Kompjuterat (aktive administrative)	3 vjet
• Pajisjet e transportit (aktive administrative)	6-7 vjet
• Mobilje e orendi (aktive administrative)	5 vjet

Me qëllimin për të paraqitur saktë shndërrimin teknologjik të Shoqërisë dhe për të qenë gjithëpërfshirës për ndikimet materiale në perspektivën financiare, do të aplikohet amortizimi i përshpejtuar për aktivet të cilat janë identifikuar si të mbivlerësuara nga palë të treta, të lidhura kryesisht me sistemet e Telekomunikacionit.

Çregjistrimi

Aktivitet afatgjatë materiale çregjistrohen kur nxirren jashtë përdorimit ose kur nga shitja apo përdorimi i tyre, nuk priten më përfitime ekonomike në të ardhmen.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit apo shitja e aktiveve afatgjatë materiale përcaktohen duke iu referuar vlerës së tyre kontabël neto dhe merren parasysh në përcaktimin e rezultatit operativ për periudhën.

Aktivitet afatgjatë jo materiale

Aktivitet afatgjatë jo materiale përfshijnë licencat si LTE, 3G, 2G dhe programet kompjuterike.

Njohja dhe matja

Licencat e blera nga Shoqëria paraqiten me kosto, minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi, në rast se ka të tilla.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse ato rritin përfitimet ekonomike të ardhshme për aktivin në fjalë. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në fitim/humbje kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi regjistrohet në fitim ose humbje duke u bazuar në metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivit duke filluar nga data kur aktivi ka qenë i disponueshëm për t'u përdorur. Jeta e dobishme e aktiveve afatgjatë jo materiale për periudhën aktuale dhe periudhat krahasuese është si më poshtë:

• Licenca	3-7 vjet
• Licenca 2G	7-15 vjet
• Licenca 3G	7-15 vjet
• Licenca 4G	15 vjet
• Programe kompjuterike	3 vjet

Aktive me të drejta përdorimi: Shoqëria jep me qira tokë dhe ndërtesa për qëllime të rrjetit, automjete dhe dyqane. Kontratat përmbajnë përbërës qiraje dhe përbërës jo qiraje. Shoqëria i shpërndan shumat e kontratës në përbërës qiraje dhe jo qiraje të bazuara në çmimet relative specifike. Megjithatë, për kontratat e qirasë së pasurive të paluajtshme për të cilat Shoqëria është qiramarrëse, nuk do të bëhet ndarja mes përbërësve të qirasë dhe jo qirasë por do të njihet një përbërës i vetëm qiraje.

Aktivitet që rrjedhin nga qiraja fillimisht njihen të matura me vlerën aktuale.

Aktivitet me të drejta përdorimi njihen të matura me kosto që përfshin:

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

- shumën e matjes fillestare të detyrimit të qirasë;
- çdo pagesë të bërë para apo në datën e fillimit të qirasë, minus minus çdo stimul qiraje të marrë;
- çdo kosto fillestare të drejtpërdrejtë, dhe;
- kosto për të rikthyer aktivin në gjendjen e përcaktuar në kontratën e qirasë.

Aktivitet me të drejta përdorimi përgjithësisht amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër mes jetës së dobishme të aktivitet dhe kohëzgjatjes së qirasë, duke përdorur metodën lineare. Nëse Shoqëria ka siguri të mjaftueshme që do të ushtrojë opsionin e blerjes, aktivitet me të drejta përdorimi do të amortizohen përgjatë jetës së dobishme të aktivitet.

Zhvlërësimi i aktiveve jo financiare

Në çdo datë raportimi, shoqëria vlerëson nëse ka ndonjë tregues për zhvlërësimin e aktiveve. Në rast se ekzistojnë këta tregues, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Për aktivitet afatgjata jomateriale që ende nuk janë të disponueshme për t'u përdorur, vlera e rikuperueshme përcaktohet në çdo datë raportimi.

Humbja nga zhvlërësimi do të njihet nëse vlera kontabël neto e aktivitet apo njësisë gjeneruese të parasë tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e parasë është njësia më e vogël e identifikueshme e grupit të aktiveve e cila gjeneron flukse monetare në mënyrë të pavarur nga aktivitet e tjera. Humbjet nga zhvlërësimi regjistrohen në fitim/humbje. Vlera e rikuperueshme e aktivitet apo njësisë gjeneruese të parasë është vlera më e madhe midis vlerës në përdorim dhe asaj të drejtë minus kostot e shitjes. Në përcaktimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme monetare të çmuara aktualizohen duke përdorur normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rrezikun specific.

Një humbje nga zhvlërësimi anulohet kur ka tregues që humbja nga zhvlërësimi nuk ekziston më dhe kanë ndryshuar supozimet e përdorura në përcaktimin e vlerës së rikuperueshme të aktivitet.

Humbja nga zhvlërësimi anulohet deri në masën që vlera e mbartur e aktivitet nuk tejkalon vlerën e mbartur që do të ishte përcaktuar, pasi të ishte zbritur zhvlërësimi apo amortizimi, nëse zhvlërësimi nuk do të ishte njohur.

Metodat kryesore të matjes së instrumentave financiarë. Vlera e drejtë është çmimi që do të merret për të shitur një aktiv ose që do të paguhet për të transferuar një pasiv në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve të tregut në datën e matjes. Treguesi më i përshtatshëm i vlerës së drejtë është çmimi në një treg aktiv. Një treg aktiv është ai në të cilin transaksionet për aktivitet ose pasivin bëhen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme.

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në treg aktiv matet si produkt i çmimit të kuotuar për aktivitet ose pasivin individual dhe numrit të instrumenteve të mbajtura nga Shoqëria. Kështu veprohet edhe nëse vëllimi normal i transaksioneve ditore të tregut është i pamjaftueshëm për të përthithur sasinë e mbajtur dhe vendosja e urdhërit për të shitur pozicionin në një transaksion mund të ndikojë në çmimin e kuotuar.

Teknikat e vlerësimit si modelet e skontimit të flukseve të mjeteve monetare ose modele të bazuara në transaksionet e fundit të krahut të punës ose shqyrtimi i të dhënave financiare të të investuarve përdoren për të matur vlerën e drejtë të instrumenteve të caktuara financiare për të cilat informacioni i çmimeve të tregut të jashtëm nuk është i disponueshëm. Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivitet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen vetëm në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (domethënë matja kërkon hyrje të rëndësishme të pavëzhgueshme).

Kostot e transaksionit janë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes, emetimit ose shitjes së një instrumenti financiar. Nuk do të kishte kosto shtesë pa kryerjen e një transaksioni. Kostot e transaksionit përfshijnë tarifën dhe komisionet që u paguhen agjentëve (përfshirë punonjësit që veprojnë si agjentë shitës), këshilltarët, agjentët dhe tregtarët, taksat nga agjencitë rregullatore dhe shkëmbimet e letrave me vlerë dhe transferimin e taksave dhe detyrimeve. Kostot e transaksionit nuk përfshijnë primet e borxheve ose zbritjet, kostot e financimit ose shpenzimet e brendshme administrative ose të mbajtjes.

Kosto e amortizuar ("KA") është shuma me të cilën është bërë njohja fillestare e instrumentit financiar duke zbritur çdo ripagim principal, plus interesin e përlogaritur; dhe për aktivitet financiare minus çdo kompensim

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

për humbjet e pritshme të kredisë ("HPK"). Interesi i përlogaritur përfshin amortizimin e kostove të transaksionit të shtyra në njohjen fillestare dhe të çdo primi ose zbritje në shumën e maturimit duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat e akumuluar të interesit dhe shpenzimet e interesit të përlogaritur, duke përfshirë edhe kuponin e akumuluar dhe zbritjen ose shpërblimin e amortizuar (përfshirë tarifat e shtyra në fillim, nëse ka), nuk paraqiten veçmas dhe përfshihen në vlerat kontabël të zërave në pasqyrën e pozicionit financiar.

Metoda e interesit efektiv është një metodë e ndarjes së të ardhurave nga interesi ose shpenzimeve të interesit gjatë periudhës përkatëse, në mënyrë që të arrihet një normë periodike konstante e interesit (norma efektive e interesit) në vlerën kontabël. Norma efektive e interesit është norma që skanton pagesat e ardhshme të parasë ose arkëtimet (duke përfshirë humbjet e ardhshme të kredisë) përgjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar ose një periudhe më të shkurtër, nëse është e përshtatshme, në vlerën kontabël neto të instrumentit financiar. Norma efektive e interesit skanton fluksin e mjeteve monetare të instrumenteve me interes të ndryshueshëm deri në datën e ardhshme të interesit, përveç primeve ose zbritjes që pasqyron diferencën e kredisë mbi normën e ndryshueshme të specifikuar në instrument ose variabla të tjerë që nuk rivendosen në normat e tregut. Primit ose zbritjet e tilla amortizohen gjatë tërë jetës së pritshme të instrumentit. Llogaritja e vlerës aktuale përfshin të gjitha pagesat e paguara ose të marra midis palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Për aktivet e zhvlerësuara që në blerje ("POCI") në njohjen fillestare, norma efektive e interesit rregullohet për rrezikun e kredisë, pra llogaritet në bazë të flukseve monetare të pritura në njohjen fillestare në vend të pagesave kontraktuale.

Instrumentet financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes ("VDNFH") fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare dëshmohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Fitim ose humbje në njohjen fillestare regjistrohet vetëm nëse ka një diferencë mes vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit, që mund të evidentohet nga transaksione të tjera aktuale të tregut për të njëjtin instrument ose nga mënyra vlerësimi që përdorin të dhëna nga tregjet e vëzhgueshme. Pas njohjes fillestare, një humbje e zbritshme për humbje të pritshme të kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse ("VDATGJ"), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Të gjitha blerjet dhe shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë shpërndarjen brenda afatit kohor të përcaktuar me rregullim ose konventë të tregut ("blerje dhe shitje" në mënyrë të rregullt) regjistrohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet për të dhënë një aktiv financiar. Të gjitha blerjet e tjera njihen kur njësisia ekonomike bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasshme – kategoritë e matjes. Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA (sipas paragrafit më lart). Klasifikimi dhe matja e mëpasme e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) Modeli i biznesit të Shoqërisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve dhe (ii) karakteristikat e fluksit monetar të aktivit.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasshme – modeli i biznesit. Modeli i biznesit reflekton mënyrën sesi shoqëria menaxhon aktivet për të gjeneruar fluks monetar – nëse objektivi i shoqërisë është: (i) vetëm mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale ("mbajtja për mbledhje e flukseve monetare") ose (ii) mbledhja e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe të flukseve monetare që gjenerohen nga shitja e aktiveve ("mbajtja për mbledhje e flukseve monetare dhe shitje") ose, nëse objektivi (i) dhe (ii) është jo i aplikueshëm, aktivet financiare klasifikohen si pjesë e modelit të biznesit "të tjera" dhe maten në VDNFH.

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet financiare (në nivel portofoli) bazuar në të gjithë evidencën përkatëse për aktivitetet që Shoqëria ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin individual në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga Shoqëria në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivitetit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar fluksit e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si kompensohet drejtimi.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matja e mëpasshme – karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare. Kur modeli i biznesit ka si objektivi mbajtjen e aktiveve për mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale ose mbledhjen e flukseve monetare kontraktuale dhe për të shitur, Shoqëria vlerëson nëse fluksit e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI").

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Aktivet financiare me derivativë të përfshirë konsiderohen në tërësinë e tyre kur përcaktohet nëse flukset monetare të tyre janë në përputhje me tiparin VPPI. Gjatë këtij vlerësimi, Shoqëria konsideron nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, pra interesi përfshin vetëm shumën për riskun e kredisë, vlerën kohore të parasë, rreziqet e tjera bazë të huadhënies dhe marzhin e fitimit.

Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë të huadhënies, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i SPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk riveleshohet më pas. Referojuni Shënimit 3 për gjykimet kritike të aplikuara nga shoqëria në kryerjen e testit VPPI për aktivet e saj financiare.

Aktivet financiare - riklasifikimi. Instrumentet financiare riklasifikohen vetëm kur modeli i biznesit për menaxhimin e portofolit në tërësi ndryshon. Riklasifikimi ka një efekt të ardhshëm dhe zhvillohet që nga fillimi i periudhës së parë të raportimit që vijon pas ndryshimit të modelit të biznesit. Shoqëria nuk ka ndryshuar modelin e saj të biznesit gjatë periudhës aktuale dhe asaj krahasuese, dhe nuk ka bërë ndonjë riklasifikim.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare – provigjioni për humbjen e kredisë nga HPK. Shoqëria vlerëson, bazuar në parashikime, HPK për instrumentet e borxhit të matura në KA dhe VDATGJ dhe për ekspozimet që rrjedhin nga angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare, për aktivet e kontratës. Shoqëria mat HPK dhe një humbjet neto të zhvlerësimit në aktivet financiare dhe të kontratës në çdo datë raportimi. Matja e HPK pasqyron: (i) një sasi të paanshme dhe të ponderuar të probabilitetit që përcaktohet duke vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, (ii) vlerën kohore të parasë dhe (iii) të gjithë informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur që është në dispozicion pa kostot dhe përpjekjet e panevojshme në fund të secilës periudhë raportuese për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme.

Instrumentet e borxhit të matura në aktivet e KA dhe aktiveve të kontratës janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar pa zbritjen për HPK. Për instrumentet e borxhit në VDAGJ, ndryshimet në koston e amortizuar, pa zbritjen për HPK, njihen në fitim ose humbje dhe ndryshimet e tjera në vlerën kontabël njihen në OCI si fitime më pak se humbjet në instrumentet e borxhit në VDAGJ.

Shoqëria zbatoi një qasje të thjeshtuar pasi nuk kishte komponentë të rëndësishëm financimi që vlerësonte ECL-në përgjatë jetës për aktivet financiare me rrezik të ulët të kredisë dhe aktivet e tjera financiare duke përfshirë llogaritë e arkëtueshme.

Aktivet financiare – fshirja. Aktivet financiare fshihen tërësisht ose pjesërisht, kur shoqëria ka kryer cdo përpjekje për rimarrje dhe ka arritur në përfundimin se nuk ka pritshmëri të arsyeshme për rimarrje. Fshirja përfaqëson një rast të çregjistrimit. Treguesit paraqesin që nuk ka gjasa të ndodhë një rikthim duke përfshirë të gjitha procedurat e ekzekutimit ose kur llogaritë e arkëtueshme shiten në shoqëritë e factoring-ut. Shoqëria mund të fshijë aktivet financiare që janë subjekt i zbatimit me forcë të marrëveshjes kur shoqëria kërkon të rikuperojë shumat që janë të arkëtueshme sipas termave kontraktuale, megjithatë, nuk ka pritshmëri të arsyeshme për marrjen e tyre.

Aktivet financiare – ç'regjistrimi. Shoqëria ç'regjiston aktivet financiare kur (a) aktivet shlyhen ose të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet përfundojnë ose (b) shoqëria ka transferuar të drejtat për arkëtimin e flukseve monetare nga aktivet financiare ose ka hyrë në një marrëveshje likuidimi ndërkohë që (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktiveve ose (ii) as nuk transferon dhe as nuk mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë, por nuk ruan kontrollin e këtyre aktiveve.

Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur aktivin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategoritë e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura në KA, përveç (i) detyrimeve financiare të matura me VDAGJ: ky klasifikim aplikohet për derivativet, detyrimet financiare të mbajtura për shitje (p.sh. pozicionet afatshkurtra me letra me vlerë), shuma e kushtëzuar e njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

Detyrimet financiare – ç'regjistrimi. Detyrimet financiare ç'regjistrohen kur ato likuidohen (psh. kur detyrimi i specifikuar në kontratë paguhet, anulohet ose skadon).

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Kompesimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompesohen dhe paraqiten neto në bilanc, vetëm kur ekziston një e drejtë ligjore për kompesimin e shumave të njohura, dhe ekziston qëllimi për shlyerje në baza neto ose realizimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë kompesimi (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjrisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast mospagimi dhe (iii) në rast mospagimi ose falimentimit. Shoqëria kompenson balancat me partnerët e interkoneksionit dhe roaming.

Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre. Mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre përfshijnë paratë në arkë dhe depozitat rrjedhëse në banka apo investime të tjera likuide afatshkurtra me maturitet origjinal tre muaj ose më pak. Mjetet monetare dhe ekuivalente me to mbahen në KA sepse: (i) ato mbahen për mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare kontraktuale dhe këto flukse monetare kontraktuale reflektojnë VPPI (ii) dhe nuk janë të dizenuara me VDNFH. Llogaritë e bllokuara përjashtohen nga paratë e gatshme dhe ekuivalentët e tyre për qëllimet e pasqyrës së rrjedhës së parasë. Llogaritë e bllokuara nga shkëmbimi ose përdorimi për të shlyer detyrimet për të paktën dymbëdhjetë muaj pas periudhës së raportimit janë përfshirë në aktivet e tjera afatgjata.

Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe në vazhdim mbarten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Llogaritë e pagueshme dhe të tjera. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera njihen kur pala tjetër përmbush detyrimet e saj të performancës sipas kontratës. Matet fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas mbahet me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Të arkëtueshmet nga qiraja financiare. Kur Shoqëria është qiradhënëse në një kontratë qiraje dhe ka transferuar në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë tek qiramarrësi, aktivet e dhëna me qira paraqiten si të arkëtueshme nga qiraja financiare në vlerën e investimit neto në qira, neto. Në datën e fillimit, matja e investimit neto në qira përbëhet nga pagesat e mëposhtme të qirasë:

- pagesat fikse (duke përfshirë pagesat fikse në thelb), minus stimujt e pagueshëm të qirasë,
- pagesat e ndryshueshme të qirasë që bazohen në një indeks ose normë, fillimisht të matura duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit,
- shumat që priten të arkëtohen nga Shoqëria si garanci për vlerat e mbetura,
- çmimi i ushtrimit të një opsioni për blerje nëse qiramarrësi ka siguri të mjaftueshme që do ta ushtrojë opsionin, dhe
- pagesat e gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse termat e kontratës reflektojnë ushtrimin e opsionit nga qiramarrësi.

Të arkëtueshmet nga qiraja financiare së pari njihen në fillim (kur fillon kohëzgjatja e qirasë), duke përdorur një normë skontimi të përcaktuar të qirasë për të matur investimin neto në qira.

Diferenca mes llogarisë së arkëtueshme bruto dhe vlerës aktuale paraqet të ardhura financiare të pafituara. E ardhura njihet përgjatë kohëzgjatjes së qirasë duke përdorur metodën e investimit neto (para tatimit), që reflekton një normë kthimi konstante dhe periodike. Kostot shtesë të cilat lidhen drejtpërdrejt me bisedimet dhe marrëveshjet për qiranë përfshihen në njohjen fillestare të shumës së arkëtueshme nga qiraja dhe ulin shumën e të ardhurave të njohura përgjatë afatit të qirasë. E ardhura financiare regjistrohet në fitimin ose humbjen e vitit.

Detyrimet nga qiratë financiare. Detyrimet që rrjedhin nga qiraja fillimisht maten duke u bazuar në vlerën aktuale. Detyrimet nga qiratë financiare përfshijnë vlerën aktuale neto të pagesave të mëposhtme të qirasë:

- pagesat fikse (duke përfshirë pagesat fikse në thelb), minus stimujt e arkëtueshëm të qirasë,
- pagesat e ndryshueshme të qirasë që bazohen në një indeks ose normë, fillimisht të matura duke përdorur indeksin ose normën në datën e fillimit,
- shumat që priten të paguhesh nga Shoqëria si garanci për vlerat e mbetura,
- çmimi i ushtrimit të një opsioni për blerje nëse Shoqëria ka siguri të mjaftueshme që do ta ushtrojë opsionin, dhe
- pagesat e gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse termat e kontratës reflektojnë ushtrimin e opsionit nga Shoqëria.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Opsionet e zgjatjes dhe përfundimit të kontratës janë përfshirë në disa kontrata qiraje të pronave dhe mjeteve. Këto terma përdoren për të maksimizuar fleksibilitetin operacional në kuadër të menaxhimit të aktiveve të përdorura në operacionet e Shoqërisë. Shumica e opsioneve të zgjatjes dhe përfundimit të kontratave mund të ushtrohen vetëm nga Shoqëria dhe jo nga qiradhënësi. Opsionet e zgjatjes (ose opsionet pas periudhës së përfundimit) përfshihen në kohëzgjatjen e qirasë vetëm nëse ka probabilitet të lartë që do të ushtrohen (ose që kontrata nuk do të përfundojë). Pagesat e qirasë për të cilat ka siguri të arsyeshme se do të kryhen pasi të ushtrohet opsioni i zgjatjes së kontratës përfshihen në matjen e detyrimit.

Pagesat e qirasë skontojnë duke përdorur normën e interesit të përcaktuar për qiranë. Nëse norma e interesit nuk mund të përcaktohet fillimisht, siç ndodh shpesh për qiratë e Shoqërisë, përdoret norma e interesit rritëse e huamarrjes së Shoqërisë, e cila është norma që Shoqëria do të duhej të paguante për të huazuar fondet e nevojshme për të marrë një aktiv me vlerë të përafërt me aktivin me të drejta përdorimi, në mjedis ekonomik, kushte dhe kolateral të ngjashëm.

Për të përcaktuar normën rritëse të huamarrjes, Shoqëria përdor normat e interesit të publikuara nga Banka Qëndrore e Shqipërisë duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen dhe monedhën.

Pagesat e qirasë ndahen mes principalit dhe kostos financiare. Kostot financiare njihen në fitim ose humbje përgjatë kohëzgjatjes së qirasë për të rezultuar në një normë interesi konstante dhe periodike për balancën e mbetur të detyrimit për çdo periudhë.

Pagesat e qirasë afatshkurtër të pajisjeve dhe qirave të aktiveve me vlerë të ulët njihen në bazën e metodes lineare si shpenzim në fitim ose humbje. Qiratë afatshkurtra janë qira me kohëzgjatje prej 12 muajsh ose më pak. Aktivet me vlerë të ulët janë aktive që e kanë vlerën më të ulët se 5,000 USD kur blihen të rinj.

Qiratë operative. Kur shoqëria është qiramarrëse në një kontratë qiraje, e cila nuk transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë nga qiradhënësi tek shoqëria, pagesat e përgjithshme të qirasë ngarkohen në fitim ose humbje për vitin në bazë lineare afatit të qirasë.

Tatimi mbi fitimin. Tatimi mbi fitimin është paraqitur në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin në fuqi ose që konsiderohet i tillë në fund të periudhës raportuese. Ngarkesa e tatimit mbi fitimin përbën tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në të ardhura dhe shpenzime për vitin, në rastin kur njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse drejtpërdrejt në kapital sepse lidhet me transaksionet që njihen gjithashtu, në të njëjtën ose në një tjetër periudhë, në të ardhura të tjera përmbledhëse ose në kapital.

Tatimi aktual është shuma që pritet të paguhet ose të rimburohet nga autoritetet tatimore në lidhje me fitimet ose humbjet e tatueshme për periudhat e tanishme dhe të mëparshme. Fitimet ose humbjet e tatueshme bazohen në vlerësimet nëse pasqyrat financiare janë të autorizuara përpara se të dorëzohen deklaratat përkatëse tatimore. Tatimet e tjera përveç tatimit mbi fitimin regjistrohen si shpenzime operative.

Tatim fitimi i shtyrë llogaritet duke përdorur metodën e pasivit të bilancit për humbjet tatimore që mbartin përpara dhe diferencat e përkohshme që lindin midis bazës tatimore të aktiveve dhe pasiveve dhe vlerave të tyre kontabël për qëllime të raportimit financiar. Në përputhje me përjashtimin fillestar të njohjes, tatimet e shtyra nuk regjistrohen për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të një aktivi ose një pasivi në një transaksion tjetër nga një kombinim biznesi nëse transaksioni, kur regjistrohet fillimisht, nuk ndikon në asnjë llogari, as fitim të tatueshëm. Bilancet tatimore të shtyra maten me normat e tatimit të miratuara ose të vendosura në fund të periudhës raportuese, të cilat pritet të zbatohen në periudhën kur do të ndryshojnë diferencat e përkohshme ose do të përdoret humbja tatimore.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore që mbarten në të ardhmen regjistrohen vetëm deri në masën që është e mundur që diferenca e përkohshme të kthehet në të ardhmen dhe ekziston fitim i mjaftueshëm i ardhshëm i tatueshëm në të cilin mund të shfrytëzohen zbritjet.

Aktivitet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e aktiveve tatimore aktuale kundrejt detyrimeve tatimore aktuale dhe kur aktivitet dhe detyrimet e tatimit mbi të ardhurat e shtyra kanë të bëjnë me tatimet mbi të ardhurat e mbledhura nga i njëjti autoritet tatimor në njësinë e njëjtë tatimore ose subjekte të ndryshme të tatueshme ku ka një qëllim për të shlyer gjendjet në baza neto.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Pozicionet e pasigurta tatimore. Pozitat e pasigurta tatimore të shoqërisë rishqyrtohen nga drejtimi në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat të cilat përcaktohen nga drejtimi, pasi ka më shumë gjasa që të mos rezultojë në vendosjen e taksave shtesë nëse pozitat do të kundërshtoheshin nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar në mënyrë thelbësore deri në fund të periudhës raportuese, dhe çdo gjykatë të njohur ose vendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për ndëshkimet, interesat dhe tatimet tjera nga të ardhurat njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të drejtimit të shpenzimeve të nevojshme për të shlyer detyrimet në fund të periudhës raportuese. Rregullimet për pozitat e pasigurta të tatimit mbi të ardhurat, përveç interesit dhe gjobave, regjistrohen brenda tatimit mbi fitimin. Rregullimet për pozitat e pasigurta të tatimit mbi fitimin në lidhje me interesin dhe gjobat regjistrohen si shpenzimeve financiare dhe fitimeve / (humbjeve) të tjera, neto.

Tatimi mbi vlerën e shtuar. Tatimi mbi vlerën e shtuar që lidhet me shitjet apo blerjen e mallrave ose shërbimeve paguhet tek autoritetet tatimore më parë (a) mbledhjen e të arkëtueshmeve nga konsumatorët ose (b) dërgimin e mallrave ose shërbimeve ndaj klientëve. TVSH-ja në blerje në përgjithësi mund të rikthehet kundrejt TVSH-së së shitjes pas marrjes së faturës së TVSH-së. Autoritetet tatimore lejojnë shlyerjen e TVSH-së në baza neto. TVSH-ja në lidhje me shitjet dhe blerjet njihet në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar në baza bruto dhe shpaloset veçmas si një aktiv dhe pasiv. Aty ku është bërë një provigjion për HPK të arkëtueshmeve, humbja nga zhvlerësimi regjistrohet për shumën bruto të debitorit, duke përfshirë TVSH-në.

Inventari. Inventari paraqitet me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Inventari përbëhet nga kartat SIM, kartat me parapagesë, aparatet dhe aksesoret përkatës dhe kancelari e pajisje të tjera të konsumueshme, paraqiten me më të voglën midis kostos dhe vlerës së realizueshme neto. Vlera e realizueshme neto është çmimi i shitjes i çmuar në rrjedhën normale të biznesit minus kostot e çmuara të përfundimit dhe realizimit të shitjes. Kosto e inventarëve llogaritet mbi bazën e metodës mesatare dhe përfshin kostot e kryera për blerjen dhe sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe gjendjen aktuale.

Parapagimet. Parapagimet njihen me kosto minus provigjionin për zhvlerësim. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti ose kur parapagimi lidhet me një aktiv që vetë klasifikohet si afatshkurtër pas njohjes fillestare. Parapagimet për blerjen e aktiveve transferohen në vlerën kontabël neto të aktivit sapo shoqëria ka marrë kontrollin e aktivitetit dhe është e mundur që përfitimet ekonomike të ardhshme që lidhen me aktivin do të rrjedhin në shoqëri. Pagesat paraprake të tjera shënohen në fitim ose humbje kur merren mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimet. Nëse ka një indikacion se aktivet, mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin nuk do të pranohen, vlera bartëse e parapagimit shlyhet në përputhje me rrethanat dhe një humbje përkatëse e zhvlerësimit njihet në të ardhurat dhe shpenzimet e vitit.

Kapitali Aksionar. Aksionet e zakonshme dhe aksionet preferenciale të pakthyeshme me dividendë diskrete janë të klasifikuara si kapital. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje, neto nga tatimi, nga të ardhurat. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si pjesë e aksioneve në kapitalin neto.

Dividendët. Dividendët regjistrohen si detyrim dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe para se pasqyrat financiare të autorizohen për t'u lëshuar, shpalosen si ngjarje pas periudhës raportuese të cilat nuk janë rregulluese. Raportet statutores të kontabilitetit të kompanisë të përgatitura në përputhje me SNRF janë bazë për shpërndarjen e fitimit dhe ndarjet tjera.

Provigjionet. Provigjionet për detyrimet janë detyrime jo financiare me kohë ose shuma të pasigurta. Provigjionet njihen kur shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si pasojë e një ngjarje të shkuar, dhe për të shlyer detyrimin do të kërkohet një përdorim i burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike për të shlyer detyrimin për të cilin mund të kryhet një vlerësim i besueshëm. Provigjionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që pritet të kërkohet për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Rritja në provigjion për shkak të kalimit të kohës njihet si një shpenzim i interesit.

Taksat dhe tarifatat, të tilla si tatimet përveç tatimit mbi të ardhurat ose tarifatat rregullatore të bazuara në

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

informacionet që lidhen me një periudhë para lindjes së detyrimit për të paguar, njihen si detyrime kur ndodh ngjarja obliguese që shkakton pagesën e taksës, siç përcaktohet nga legjislacioni që shkakton detyrimin për të paguar taksën. Nëse një taksë paguhet përpara ngjarjes detyruese, ajo njihet si parapagim.

Detyrime për tërheqjen e aktiveve. Shpenzimet e çmontimit dhe heqjes së një zëri të aktiveve afatgjata materiale (detyrime për kthimin e aktiveve në gjendje normale) shtohen në koston e zërit ose kur një zë është blerë ose zëri është përdorur gjatë një periudhe të caktuar për qëllime të tjera nga prodhimi i inventarëve gjatë kësaj periudhe. Kur ka ndryshime në matjen e një detyrimi ekzistues të ketyre aktiveve për shkak të ndryshimeve në kohën ose shumën e parashikuar të rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitimet ekonomike të kërkuara për të shlyer detyrimin ose nga ndryshimet në normën e skontimit, kostoja e aktivitetit përkatës rregullohet nëse aktivi përkatës matet duke përdorur modelin e koston ose suficitin i rivlerësimit është rregulluar nëse aktivi matet duke përdorur modelin e rivlerësimit.

Njohja e të ardhurave. Të ardhurat i përkasin aktiviteteve të zakonshme të Shoqërisë. Të ardhurat njihen në shumën e çmimit të transaksionit. Çmimi i transaksionit është shuma për të cilën Shoqëria pret t'i përkasi në këmbim të transferimit të kontrollit mbi mallrat apo shërbimet e premtuara për një klient, duke përjashtuar shumat e mbledhura në emër të palëve të treta.

Të ardhurat njihen neto nga uljet, kthimet dhe taksat e vlerës së shtuar, pagesa të tjera të ngjashme të detyrueshme.

Shitjet nga shërbimet e telekomunikacionit

Shoqëria siguron shërbime me kontrata me çmim fiks dhe me çmime të ndryshueshme. Të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve njihen në periudhën kontabël në të cilën shërbimet ofrohen. Për kontratat me çmim fiks, të ardhurat njihen në bazë të shërbimit aktual të ofruar deri në fund të periudhës raportuese si një pjesë e totalit të shërbimeve që duhet të ofrohen, sepse klienti merr dhe përdor përfitimet në të njëjtën kohë.

Kur kontratat përfshijnë detyrime të shumfishta të performancës, çmimi i transaksionit ndahet për secilën detyrim të veçantë të performancës bazuar në çmimet shitëse të pavarura. Kur ato nuk janë drejtpërdrejtë të vëzhgueshme, ato vlerësohen bazuar në koston e pritshme plus marzhin.

Shumë nga kontratat e shërbimeve të shoqërisë përfshijnë produkte të shumta, të tilla si shitja e pajisjeve dhe / ose shërbimeve të lidhura me instalimin. Instalimi është i thjeshtë, nuk përfshin një shërbim integrimi dhe mund të kryhet nga një palë tjetër. Prandaj llogaritet si një detyrim i veçantë i performancës. Nëse kontratat përfshijnë instalimin e harduerit, të ardhurat për harduer njihen në një moment në momentin e dorëzimit të harduerit, titulli ligjor ka kaluar dhe klienti ka pranuar harduerin.

Përlllogaritjet e të ardhurave, kostove ose shtrirjes së progresit drejt përfundimit rishikohen nëse rrethanat ndryshojnë. Çdo rritje apo ulje e rezultateve në të ardhurat ose koston e vlerësuar reflektohet në fitimin ose humbjen në periudhën në të cilën rrethanat që krijojnë rishikimin bëhen të njohura nga Drejtimi.

Në rastin e kontratave me çmim fiks, klienti paguan shumën fikse bazuar në një skemë pagesash. Nëse shërbimet e kryera nga shoqëria tejkalojnë pagesën, një aktiv i kontratës njihet. Nëse pagesat tejkalojnë shërbimet e kryera, njihet një detyrim kontratual.

Nëse kontrata përfshin një tarifë orare, të ardhurat njihen në shumën në të cilën shoqëria ka të drejtë të faturohet. Konsumatorët faturohen në baza mujore dhe konsiderata paguhet kur faturohet.

Nëse kontrata përfshin shumën e ndryshueshme, të ardhurat njihen vetëm në masën që është shumë e mundshme që nuk do të ketë ndryshim të konsiderueshëm të një konsiderate të tillë.

Konsumatorët faturohen në baza mujore dhe paguhet kur faturohet.

Të ardhurat nga shërbimet përbëhen nga elementët e mëposhtëm. Nëse kontratat përfshijnë detyrime të shumfishta të performancës, trajtohen si shpjeguar më lart.

Tarifat mujore. Të ardhurat e lidhura me tarifën mujore për shërbimet e rrjetit njihen në të njëjtin muaj kur shërbimi i telekomunikacionit ofrohet siç është përcaktuar në kontratat me konsumatorët.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Tarifat e përdorimit dhe tarifat për shërbimet shtesë. Tarifat e thirrjeve konsistojnë në tarifa për kohën e bisedës dhe trafikun e gjeneruar nga telefonuesi, destinacionin e telefonatës dhe shërbimin e përdorur.

Tarifat e përdorimit bazohen në trafikun e gjeneruar, përdorimin e kohës së bisedës ose volumnin e transmetimit të të dhënave për shërbimet shtesë, si mesazhet e shkurtra, përdorimin e internetit dhe shërbimin e të dhënave.

Të ardhurat nga tarifat e përdorimit dhe shërbimet shtesë njihen në periudhën kur këto shërbime u sigurohen abonentëve. Të ardhurat e pafaturuara nga cikli i faturimeve, në datën e fundit të çdo muaji vlerësohen bazuar në trafikun e gjeneruar dhe regjistrohen në fund të çdo muaji.

Të ardhurat nga shitja e kartave telefonike me parapagim dhe kohës së parapaguar, të përfshira në paketën e shoqërisë për shërbimet e parapaguara, njihen në bazë të përdorimit. Koha e papërdorur e paketave me parapagim regjistrohet si e ardhur e shtyrë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Tarifat roaming. Tarifat roaming faturohen për çdo minutë kundrejt operatorëve të tjerë për abonentët e tyre që përdorin rrjetin e shoqërisë. Në mënyrë të ngjashme, operatorët e tjerë të rrjeteve celulare faturojnë shoqërinë për përdorimin e rrjeteve të tyre nga abonentët e kësaj të fundit. Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në periudhën kur janë kryer shërbimet.

Tarifat e interkonjeksionit. Trafiku i gjeneruar midis dy shoqërive të telekomunikacionit menaxhohet përmes procesit të interkonjeksionit. Shoqëria e telekomunikacionit e abonentit që kryen një thirrje pëson në të njëjtën kohë një shpenzim ndërsa shoqëria ku telefonata përfundon realizon një të ardhur duke faturuar shoqërinë e telekomunikacionit të abonentit thirrës.

Të ardhurat e interkonjeksionit realizohen nga telefonatat e përfunduara në rrjetin e Telekom Albania ndërkohë që janë gjeneruar nga rrjete të operatorëve fiks apo lëvizës vendas apo të huaj.

Të gjithë regjistrimet që kanë Telekom Albania si numër thirrës dhe një abonent të një shoqërie tjetër si numër të thirrur, krijojnë një shpenzim për Telekom Albania. Kostot e interkonjeksionit burojnë nga të gjithë thirrjet që krijohen në rrjetin e Shoqërisë dhe përfundojnë në rrjetet e operatorëve të telefonisë fikse dhe celulare të huaja dhe vendase, duke përdorur rrjetet e shoqërisë. Këto të ardhura (dhe shpenzime) njihen në fitim/humbje në momentin kur thirrja mbërrin në rrjetin e shoqërisë (në rrjetin e operatorëve të tjerë).

Të drejtat e përdorimit. Shoqëria gjithashtu jep të drejtat e përdorimit të rrjetit të brezit të gjerësisë dhe të fibrave optike të telekomunikacionit për të cilat të ardhurat njihen në bazë të drejtpërdrejtë pasi që përfaqëson më së miri mënyrën se si gjenerohet të ardhura, pra me kalimin e kohës, për shkak se klienti:

- konsumatori në të njëjtën kohë merr dhe konsumon të gjitha përfitimet e ofruara nga shoqëria (siguron të drejtat për përdorimin e rrjetit të saj të brezit të gjerësisë dhe të telekomunikacionit me fibra optike);
- ecuria e shoqëria nuk krijon një aktiv me një përdorim alternativ për njësinë ekonomike dhe njësinë ekonomike ka një të drejtë ekzekutive për pagesë për performancën e kryer deri më tani.

Shitje e mallrave. Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur Shoqëria shet një produkt tek klienti. Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen në momentin e transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve të pronësisë së mallrave, normalisht në pikën e shitjes. Të ardhurat nga shitja e aparateve dhe aksesoreve, në zbritje të zbritjeve të lejuara, njihen me dorëzimin e mallrave kur e drejta dhe rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të pronësisë i kalojnë klientit. Kthimet historikisht kanë qenë të kufizuara dhe prandaj shoqëria nuk ka ngritur një provision në llogaritë e saj. Shoqëria nuk vepron në programet e besnikërisë së klientit, në të cilin rast do të duhet të ngrejë një detyrim kontrate derisa të shpërblehen të drejtat e klientit.

Marrëveshjet e konsumatorëve me parapagese përfshijnë shitjen e pajisjeve dhe shitjen e shërbimeve. Shoqëria konsideron se shitja e pajisjeve dhe shitja e shërbimit (shërbimeve) është detyrim i veçantë i performancës. Këto njësi identifikohen dhe ndahen, pasi ato kanë vlerë në baza të pavarura dhe shiten në një pako ose veç e veç. Prandaj, shoqëria njih të ardhurat për këto elemente kur pajisja i dorëzohet klientit duke përdorur metodën e alokimit të çmimit të blerjes të përshkruar më sipër.

2. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Komponentët financiarë. Shoqëria nuk pret që të ketë kontrata ku periudha ndërmjet transferimit të mallrave ose shërbimeve të premtuara ndaj klientit dhe pagesa nga klienti tejkalon një vit. Si pasojë, Shoqëria nuk rregullon asnjë nga çmimet e transaksionit për vlerën kohore të parasë.

Të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi regjistrohen për të gjitha instrumentet e borxhit në bazë akruale duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kjo metodë shlyen, si pjesë e të ardhurave nga interesi, të gjitha tarifën e marra midis palëve në kontratë që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv, të gjitha primet e tjera ose zbritjet.

Tarifat integrale me normën efektive të interesit përfshijnë tarifën e origjinës të marra ose të paguara nga shoqëria lidhur me krijimin ose blerjen e një aktivi financiar, për shembull tarifën për vlerësimin e aftësisë kreditore, vlerësimin dhe regjistrimin e garancive ose kolateralit, negocimin e kushteve të instrumentit dhe për përpunimin e dokumenteve të transaksionit.

Të ardhurat nga interesi llogariten duke zbatuar normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të aktiveve financiare, përveç (i) aktiveve financiare që kanë pësuar rënie të kredisë (Faza 3), për të cilat llogaritet të ardhurat nga interesi duke zbatuar normën efektive të interesit të tyre AC, neto nga provigjioni HPK dhe (ii) aktivet financiare që janë blerë ose kanë origjinën nga kreditë e dëmtuara, për të cilat norma e interesit efektiv të rregulluar nga kredia është aplikuar për KA.

Përfitimet e punonjësve

Pensionet e detyrueshme. Gjatë aktivitetit normal të biznesit, shoqëria kryen pagesa kontributesh për llogari të saj dhe të punonjësve për të kontribuar në skemën e detyrueshme të sigurimeve shoqërore në përputhje me legjislacionin vendas. Kostot e kryera për llogari të shoqërisë në këtë skemë me kontribute të përcaktuara njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

Rregullimi i gabimeve të periudhave të mëparshme. Gabimet mund të lindin në lidhje me njohjen, matjen, paraqitjen apo shpjegimet e elementëve të pasqyrave financiare. Referuar SNK 8, një njësi ekonomike duhet të rregullojë gabimet materiale të periudhave të mëparshme në mënyrë retrospektive, në pasqyrat e para financiare të autorizuara pas zbulimit të gabimit, përveç rasteve kur është jopraktike. Gjatë 2019, Shoqëria identifikoi dhe korrigjoi gabimet e periudhave të mëparshme duke rregulluar balancën hapëse të fitimit të pashpërndarë në 1 Janar 2019. Korrigjimi është si më poshtë:

Përshkrimi	Shumat në lekë
Rregullimi i ndikimit për HPK nga zbatimi për herë të parë i SNRF 9	39,440
Fshirja e parapagimeve për procedurat e mbylljes dhe çështjet ligjore	48,754
Parapagime për kontrata qiraje të përfunduara	24,852
Korrigjime të tjera	17,799
Totali	130,845

Shoqëria ka riklasifikuar fitimet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe të ardhurat e tjera në shumën 9,951 mijë lekë nga të ardhura/shpenzime të tjera tek të ardhura nga kontratat me klientët. Gjithashtu, Shoqëria ka riklasifikuar shumën prej 18,546 mijë lekë nga shpenzime të përgjithshme, të shitjes dhe administrative në shpenzime për shërbimet e ofruara.

3. Vlerësime të rëndësishme të kontabilitetit dhe gjykime në zbatimin e politikave kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime. Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen mbi bazën e parimit të vijimësisë. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme.

Gjykimet që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare dhe vlerësimet që mund të shkaktojnë një rregullim domethënës në vlerën kontabël të aktiveve dhe pasiveve brenda vitit të ardhshëm financiar përfshijnë:

Jeta e dobishme e aktiveve afatgjata materiale.

Vlerësimi i jetës së dobishme të zërave të aktiveve afatgjata materiale është çështje e gjykimit bazuar në përvojën me aktive ngjashme. Përfitimet ekonomike të ardhshme të aktiveve konsumohen kryesisht përmes përdorimit. Megjithatë, faktorë të tjerë, siç janë vjetërsia teknike dhe komerciale dhe konsumimi, shpesh rezultojnë në zvogëlimin e përfitimeve ekonomike të mishëruara në asete. Drejtimi vlerëson jetën e dobishme të mbetur në përputhje me kushtet aktuale teknike të aktiveve dhe periudhën e vlerësuar gjatë së cilës pritet që asetet të fitojnë përfitime për Shoqërinë. Janë konsideruar faktorët kryesorë në vijim: (a) përdorimi i pritur i aktiveve dhe zhvillimet e nevojshme teknologjike; (b) vlera e pritshme e demtimit nga përdorimi, i cili varet nga faktorët operacionalë dhe programi i mirëmbajtjes; dhe (c) vjetërsimi teknik ose komercial që rrjedh nga ndryshimet në kushtet e tregut dhe nevojat e klientit për performance absolute.

Nëse jeta e dobishme e vlerësuar do të ndryshonte me 10% nga vlerësimet e drejtimit, ndikimi mbi amortizimin për periudhën e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 do të ishte rritja e saj me 170,189 mijë lekë ose ulja me 140,652 mijë lekë (2018: rritje me 125,761 mijë lekë ose ulje me 103,935 mijë lekë).

Vlerësimi i pronave

Aktivitet administrativ dhe të rjetit të Shoqërisë maten në vlerën e drejtë bazuar në raportet e përgatitura nga një shoqëri e pavarur kombëtare vlerësimi ose nga ekipi teknik i Shoqërisë.

Në përgatitjen e raportit të vlerësimit për ndërtesën e Shoqërisë, vlerësuesi i jashtëm përjashtoi shitjet në gjendje të vështirë kur mori në konsideratë çmime të krahasueshme të shitjeve. Drejtimi ka rishikuar supozimet e vlerësuesve në bazë të alternativave të shitjes të përdorura në vlerësim, dhe konfirmoi se faktorët e zbatuar siç janë vendndodhja, madhësia e ndërtesës dhe hapësira e përdorshme, mosha dhe gjendja, përmirësimet dhe fuqia blerëse e blerësve, janë përcaktuar si duhet duke marrë parasysh kushtet e tregut në datën e rivlerësimit. Pavarësisht nga sa më sipër, drejtimi konsideron se vlerësimi i ndërtesës aktualisht është subjekt i një shkalle të rritur gjykimi dhe ka më shumë gjasa që arkëtimet aktuale nga një shitje mund të ndryshojnë nga vlera kontabël.

Për ndërtesën në Laprakë për të cilën është përdorur Metoda e të Ardhurave, analiza e ndjeshmërisë paraqitet si më poshtë:

-Norma e kapitalizimit u konsiderua 9.5%. Nëse kjo normë kapitalizimi rritet / ulët me 1 pikë përqindje, vlera kontabël e godinave do të ishte 12,712 mijë lekë më e ulët / 12,712 mijë lekë më e lartë.

-Të ardhurat e mundshme nga qiraja e pasurive u konsideruan 32,622 mijë lekë në vit. Nëse këto të ardhura nga qiraja rriten / ulen me 10 përqind, vlera kontabël e godinave do të ishte 49,512 mijë lekë më e lartë / 49,512 mijë lekë më e ulët.

Supozimet kryesore të lartpërmendura që mbështesin vlerësimin e vlerës së drejtë krahasohen rregullisht me të dhënat aktuale të tregut dhe transaksionet aktuale nga ana e Shoqërisë dhe ato të raportuara nga tregu.

3. Vlerësime të rëndësishme të kontabilitetit dhe gjykime në zbatimin e politikave kontabël (Vazhdim)

Vlerësimi i sistemeve dhe rrjeteve të telekomunikacionit

Për shkak të natyrës së aktiveve të rrjetit të cilat janë mjaft specifike dhe me risi, si dhe mungesës së të dhënave të krahasueshme në masë të tregut, vlera e drejtë llogaritet në çmimin e shitjes të ofruar nga palët e treta për aktivet e Shoqërisë duke marrë parasysh vlerën e tyre aktuale të tregut. Drejtimi ka rishikuar vlerën e aktiveve që pritet të shfrytëzohen për një periudhë 5-7 vjet ndërsa aktivet nën të njëjtën kategori që do të zëvendësohen në 3-5 vitet e ardhshme nuk janë rivlerësuar dhe zhvlerësimi i tyre nuk është fshirë pasi këto konsiderohen të ndara nga aktivet e përmirësuara të rrjetit të cilat gradualisht do t'i zëvendësojnë ato.

Njohja e aktiveve tatimore të shtyra. Aktivet tatimore të shtyra përfaqësojnë tatimet në të ardhura të rikuperueshme nëpërmjet zbritjeve të ardhshme nga zbritje të ardhshme të fitimit të tatueshëm dhe njihen në pasqyrën e pozicionit financiar, duke kompensuar detyrimet e tatimit mbi fitimin të shtyrë. Aktivet e tatimit mbi fitimin e shtyrë regjistrohen në masën që realizimi i përfitimit tatimor është i mundshëm. Kjo përfshin diferencën e përkohshme që pritet të ndryshojë në të ardhmen dhe disponueshmërinë e fitimit të mjaftueshëm të ardhshëm, ndaj të cilit mund të shfrytëzohen zbritjet. Aktivet tatimore të shtyra janë njohur gjatë periudhës raportuese duke marrë parasysh rezultatet positive të Shoqërisë, pasi ato nuk janë njohur që prej 2017 për shkak të rezultateve negative dhe rezultateve të ardhshme të pasigurta. Fitimet e ardhshme të tatueshme dhe vlera e përfitimit tatimor që janë të mundshme të ndodhin në të ardhmen, bazohen në planin e biznesit afatmesëm të përgatitur nga drejtimi dhe më pas me rezultate të ekstrapoluara. Plani i biznesit bazohet në pritshmëritë e drejtimit të cilat besohet të jenë të arsyeshme në këto rrethana.

Tatimi mbi fitimin e kapitalit për ndryshimin e pronësisë. Shoqëria bazuar në këshillat e ekspertëve ka shqyrtuar kërkesat e aktit të tatimit mbi fitimin në lidhje me tatimin mbi fitimin e kapitalit dhe ka llogaritur një vlerë maksimale të tatimit mbi fitimin e kapitalit në lekë për shkak të vlerës më të ulët të aktiveve neto të Shoqërisë në krahasim me bazën e tyre tatimore më 30 Prill 2019. Referojuni shënimit 11 për gjykimet e bëra dhe paqartësitë e lidhura.

Opsionet e zgjatjes dhe përfundimit. Në përcaktimin e afatit të qirasë, drejtimi merr në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat që krijojnë një stimul ekonomik për të ushtruar një mundësi zgjatjeje, ose për të mos ushtruar një opsion përfundimi. Opsionet e zgjatjes (ose periudhat pas opsioneve të përfundimit) përfshihen në afatin e qirasë vetëm nëse ka siguri të arsyeshme se qiraja do të zgjatet (ose nuk përfundon).

Për qiratë e ndërtesave, faktorët e mëposhtëm janë zakonisht më të rëndësishmit:

- Nëse ka penalitete të konsiderueshme për të përfunduar (ose për të mos zgjatur), Shoqëria ka siguri të arsyeshme se do të zgjasë (ose të mos përfundojë).
- Nëse ndonjë përmirësim i qirasë pritet të ketë një vlerë të mbetur të konsiderueshme, Shoqëria ka siguri të arsyeshme se do të zgjasë (ose të mos përfundojë).
- Përndryshe, Shoqëria merr në konsideratë faktorë të tjerë, përfshirë kohëzgjatjet dhe shpenzimet historike të qirasë dhe ndërprerjen e veprimtarisë së biznesit që nevojitet për të zëvendësuar aktivin e marrë me qira.

Afati i qirasë rivlerësohet nëse një opsion është realizuar (ose nuk është ushtruar) ose Shoqëria detyrohet ta ushtrojë (ose të mos e ushtrojë) atë. Vlerësimi i një sigurie të arsyeshme rishikohet vetëm nëse ndodh një ngjarje e rëndësishme ose një ndryshim i rëndësishëm në rrethana, i cili ndikon në këtë vlerësim, dhe që është nën kontrollin e qiramarrësit.

3. Vlerësime të rëndësishme të kontabilitetit dhe gjykime në zbatimin e politikave kontabël (Vazhdim)

Informacion shtesë për fushat e rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimet kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumën e njohur në pasqyrat financiare përshkruhet në shënime të mëposhtme:

- Shënimi 11 – Tatimi mbi fitimin (tatime kreditore të fitimit në kapital)
- Shënimi 12 – Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale
- Shënimi 16 – Zhvlerësimi i aktiveve të arkëtueshme
- Shënimi 23 – Provigjione për detyrimet dhe tarifën dhe detyrimet për tërheqjen e aktiveve
- Shënimi 31 – Angazhime dhe detytime të kushtëzuara për çështje gjyqësore ndaj Shoqërisë
- Shënimi 30 – Trajtimi i detyrimeve nga marrëveshjet e përbashkëta të huave

4. Zbatimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara

Shoqëria vendosi të zbatojë standardin nga 1 Janar 2019, data e tij e detyrueshme për zbatim, duke përdorur metodën e modifikuar retrospektive, pa riparaqitur shifrat krahasuese dhe duke përdorur disa lehtësira të lejueshme nga standardi. Të gjitha aktivet me të drejtë përdorimi maten në vlerën e detyrimit të qirasë në momentin e zbatimit.

Shoqëria njohu detyrime për qira në lidhje me qiratë e klasifikuara më pare si operative sipas SNK 17, Qiratë. Këto detyrime u matën me vlerën e drejtë të pagesave të mbetura të qirasë, të skontuara duke përdorur normën rritëse të huamarrjes së qiramarrësit më 1 Janar 2019. Norma mesatare rritëse e huamarrjes e aplikuar nga Shoqëria për detyrimet e qirasë më 1 Janar 2019 ishte 6.341%.

Në aplikimin e SNRF 16 për herë të parë, Shoqëria ka përdorur lehtësitë praktike të mëposhtme të lejuara nga standardi:

- aplikimi i një norme të vetme skontimi në portofolin e qirave me karakteristika të ngjashme në mënyrë të arsyeshme,
- duke u mbështetur në vlerësimet e mëparshme nëse qiraja është me kushte të vështira si një alternativë për të kryer një rishikim të zhvlerësimit - nuk ka pasur kontrata të tilla në 1 Janar 2019,
- llogaritjen e qirave operative me një afat të mbetur qiraje më pak se 12 muaj nga 1 Janari 2019 si qira afatshkurtra,
- duke përjashtuar kostot fillestare direkte për matjen e aktivitetit të drejtë përdorimi në datën e aplikimit fillestar, dhe
- duke përdorur mbikëqyrje në përcaktimin e afatit të qirasë, kur kontrata përmban mundësi për zgjatjen ose përfundimin e qirasë.

Shoqëria ka zgjedhur të mos rivlerësojë nëse një kontratë është ose përmban një qira në datën e aplikimit fillestar. Në vend të kësaj, për kontratat e lidhura përpara datës së tranzicionit Shoqëria është mbështetur mbi vlerësimin e bërë me aplikimin e SNK 17, Qiratë dhe KIRFN 4 'Përcaktimi nëse një marrëveshje përmban një "qira"

Më 31 Dhjetor 2018 Shoqëria kishte detyrime qiraje të pa-anullueshme prej 916,334 mijë lekë vetëm për qiratë e vendndodhjeve të rrjetit.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE- 31 DHJETOR 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

4. Zbatimi i interpretimeve dhe standardeve të reja ose të rishikuara (vazhdim)

Një krahasim i angazhimeve të qirasë operative për detyrimin e njohur është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018 / 1 Janar 2019
Pagesat minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të paanullueshme* më 31 dhjetor 2018 –	(916,334)
Vendndodhjet e rrjetit	
• Rregullim për pagesat minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të paanullueshme më 31 dhjetor 2018 – Vendndodhjet e rrjetit	(109,255)
• Rregullim për pagesat minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të paanullueshme më 31 dhjetor 2018 – Mjete motorrike	(121,499)
• Rregullim për pagesat minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të paanullueshme më 31 dhjetor 2018 – Dyqanet me pakicë	(108,302)
Pagesat minimale të ardhshme të qirasë për qiratë operative të paanullueshme* më 31 dhjetor 2018	(1,255,390)
- Detyrime për qira financiare të njohura më 31 dhjetor 2018	
- Pagesa të ardhshme të qirasë, rezultat i trajtimit ndryshe për zgjatjen e afatit	
Opsionet e përfundimit	
- Pagesa variable të ardhshme të qirasë bazuar në një indeks ose normë	
-Efekti i skontimit në vlerën aktuale	202,567
-Minus qira afatshkurtra që nuk njihen si detyrime	
-Minus qiratë me vlerë të ulët që nuk njihen si detyrime	
Totali i detyrimit për qira i njohur në 1 Janar 2019 (Shënimi 13)	(1,052,823)
Nga të cilat:	
Detyrime për qira afatshkurtra	(257,034)
Detyrime për qira afatgjata	(795,789)

* Qiratë e paanullueshme përfshijnë vetëm ato që janë të anulueshme (a) nëse shfaqet një kusht i largët, (b) me aprovimin e qiradhënësit, (c) nëse qiramarrësi hyn në një kontratë të re për një aktiv të njejtë ose të ngjashëm ose (d) nëse ka pagesa nga qiramarrësi për këtë vlerë shtesë, që në fillim të qirasë dhe vazhdimësia e saj është siguri e arsyeshme.

Standardet e mëposhtme të ndryshuara u bënë efektive për Shoqërinë nga 1 janari 2019, por nuk patën ndonjë ndikim material në Shoqëri:

- KIRFN 23 "Pasiguria mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat" (lëshuar në 7 qershor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshime në SNRF 9 (lëshuar në 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 "Interesat afatgjata në bashkëpunëtorë dhe sipërmarrje të përbashkët" (lëshuar më 12 tetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Përmirësime Vjetore të Ciklit të SNRF 2015-2017 - ndryshime në SNRF 3, SNRF 11, SNK 12 dhe SNK 23 (lëshuar më 12 dhjetor 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- Ndryshimet në SNK 19 "Plani i ndryshimit, ndalimit ose zgjidhjes" (lëshuar në 7 shkurt 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).

5. Standardet e reja kontabël

Disa standarde dhe interpretime të reja të publikuara dhe që janë të detyrueshme për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020 ose më vonë, të cilat Shoqëria nuk i ka miratuar në mënyrë të hershme.

- SNRF 17 "Kontratat e Sigurimeve" (publikuar më 18 maj 2017 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- Ndryshimet në kuadrin konceptual për raportim financiar (publikuar më 29 mars 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Përkufizimi i një biznesi – Ndryshimet në SNRF 3 (publikuar më 22 tetor dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020)
- Përkufizimi i Materialitetit – Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8 (publikuar më 31 tetor 2018 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020).
- Shitja ose dhurimi i aktiveve midis një Investitori dhe Bashkëpunëtorit të tij ose sipërmarrjes së përbashkët - Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28 (të publikuara më 11 shtator 2014 dhe efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas një date që do të përcaktohet nga BSNK)..

Standardet dhe interpretimet e reja nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE- 31 DHJETOR 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

6. Të ardhura nga kontratat me klientët

Shoqëria gjeneron të ardhura nga transferimi i produkteve dhe shërbimeve përgjatë një periudhe kohore ose në një moment në kohë për linjat kryesore të produkteve, si më poshtë:

	2019	2018
<i>Të ardhura nga shërbimet e telekomunikacionit:</i>		
Të ardhura nga shërbimet me parapagim dhe kontratë	5,752,944	5,572,351
Të ardhura nga interkonjeksioni	2,175,339	2,657,574
Të ardhura nga roaming	157,023	184,367
Të ardhura të tjera operative	123,629	197,536
Totali	8,208,935	8,611,828
<i>Të ardhura nga shitja e produkteve:</i>		
Rreziku i likuiditetit. Rreziku i likuiditetit është rreziku që një shoqëri do të ketë vështirësi në shlyerjen e detyrimeve që lidhen me detyrimet financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj kerkesave të përditshme në burimet e mjeteve monetare. Rreziku i likuiditetit menaxhohet nga Departamenti i Thesarit të Shoqërisë. Menaxhimi monitoron çdo muaj parashikimet e flukseve monetare të Shoqërisë nëpërmjet Departamentit të Thesarit.

Për shkak të marrëveshjes së përbashkët të huasë (Shënimi 30), Shoqëria kanalizon likuidet e saj përmes FIB Shqipëri. Shoqëria mban mënjandë paratë e nevojshme për menaxhimin e kapitalit punues. Teprica e mjeteve monetare depozitohet si shlyerje e borxhit ATI ndaj FIB Bullgari.

Shoqëria kërkon të mbajë një bazë të qëndrueshme të financimit, e cila kryesisht përbëhet nga të pagueshme tregtare dhe të tjera. Portofoli i likuiditetit të Grupit përfshin mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre (Shënimi 18). Drejtimi vlerëson se paratë e portofolit të likuiditetit, depozitat bankare mund të realizohen me para në një kohë të arsyeshme për të përmbushur kërkesat e paparashikuara të likuiditetit.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE- 31 DHJETOR 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Pozicioni i likuiditetit monitorohet dhe testimi i stresit të likuiditetit rregullisht nën një skenar të ndryshëm që mbulon kushte normale dhe më të rënda të tregut kryhet nga Departamenti i Thesarit.

Tabela më poshtë tregon detyrimet në 31 dhjetor 2019 nga afati kontraktual i mbetur. Shumat e shpalosura në tabelën e maturimit janë flukset monetare kontraktuale të paskontuara, përfshirë detyrimet e qirasë financiare bruto (para zbritjes së tarifave financiare të ardhshme), të pagueshmet tregtare, garancitë financiare dhe detyrimet e tjera financiare. Flukset e tilla të mjeteve monetare të paskontuara ndryshojnë nga shuma e përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar sepse vlera në pasqyrën e pozicionit financiar bazohet në flukset monetare të skontuara.

Kur shuma e pagueshme nuk është fikse, vlera në informacionin shpjegues përcaktohet duke iu referuar kushteve që ekzistojnë në fund të periudhës së raportimit. Pagesat në valutë të huaj janë përkthyer duke përdorur kursin e këmbimit të çastit në fund të periudhës raportuese.

Vlerat në maturim të paskontuara të detyrimeve financiare sipas kontratave janë si më poshtë:

Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2019	Vlera e mbetur	Totali	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 muaj deri 1 vit	1 vit deri 5 vjet	Mbi 5 vjet
Llogari të pagueshme (shënimi 24)	3,848,238	3,848,238	3,848,238	-	-	-	-
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura (shënimi 30)	100	100	100	-	-	-	-
Shpenzime të përlogaritura dhe detyrime të tjera afatshkurtra (shënimi 25 dhe 19)	673,875	673,875	673,875	-	-	-	-
Detyrime për qira (shënimi 13)	1,037,200	1,214,144	109,187	153,377	34,544	743,088	173,949
Totali i detyrimeve financiare	5,559,413	5,736,357	4,631,400	153,377	34,544	743,088	173,949

Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2018	Vlera e mbetur	Totali	Deri në 1 muaj	1 deri 3 muaj	3 muaj deri 1 vit
Llogari të pagueshme (shënimi 24)	3,794,980	3,794,980	3,794,980	-	-
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura (shënimi 30)	861,463	861,463	861,463	-	-
Shpenzime të përlogaritura dhe detyrime të tjera afatshkurtra (shënimi 25 dhe 19)	574,002	574,002	574,002	-	-
Detyrime për qira financiare	3,803	4,976	-	-	4,976
Totali i detyrimeve financiare	5,234,248	5,235,421	5,230,445	-	4,976

Rreziku i tregut. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rreziqeve të tregut. Rreziqet e tregut lindin nga pozicionet e hapura në (a) monedhë, (b) normat e interesit dhe (c) produkte të kapitalit, të cilat janë të ekspozuara ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe specifike të tregut. Drejtimi vendos kufij mbi vlerën e rrezikut që mund të pranohet, i cili monitorohet çdo ditë. Sidoqoftë, përdorimi i kësaj qasje nuk parandalon humbje jashtë këtyre kufijve në rast të lëvizjeve më të rëndësishme të tregut.

Rreziku i monedhës. Në lidhje me rrezikun e monedhës, drejtimi vendos kufij në nivelin e ekspozimit sipas monedhës dhe në total për pozicionet brenda natës dhe brenda ditës, të cilat monitorohen çdo ditë.

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE- 31 DHJETOR 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Tabela e mëposhtme është një përmbledhje e ekspozimit të Shoqërisë ndaj rrezikut të monedhës nga këmbimi valuator në fund të periudhës raportuese

31 Dhjetor 2019	Vlera e mbetur	Euro	USD	Lekë
Llogaritë e arkëtueshme dhe huatë	795,792	399,939	11,713	384,139
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	1,901,014	856,931	29,610	1,014,473
Të arkëtueshme nga qiraja financiare	34,326	(7,191)	-	41,517
Llogari të pagueshme (shënimi 24)	(3,848,338)	(1,227,789)	(95,554)	(2,524,996)
Shpenzime të përlogaritura dhe detyrime të tjera afatshkurtra (shënimi 25 dhe 19)	(673,875)	(392,558)	(188,224)	(93,094)
Detyrime për qira financiare	(1,037,200)	(300,644)	(3,740)	(732,816)
Ekspozimi neto	(2,828,281)	(671,312)	(246,195)	(1,910,777)
Detyrime jashtë bilancit	(4,654,049)	(4,654,049)		
Ekspozimi neto në dhe jashtë bilancit	(7,482,330)	(5,325,361)	(246,195)	(1,910,777)

31 Dhjetor 2018	Vlera e mbetur	Euro	USD	Lekë
Llogaritë e arkëtueshme dhe huatë	44,040,590	43,305,053	200,953	534,585
Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre	11,490,839	9,471,733	425,337	1,593,769
Të arkëtueshme nga qiraja financiare	(3,803)	(3,803)		
Llogari të pagueshme (shënimi 24)	(3,794,980)	(1,467,086)	(92,396)	(2,235,498)
Të pagueshme me palët e lidhura (shënimi 30)	(861,463)	(753,899)	(17,362)	(90,203)
Shpenzime të përlogaritura dhe detyrime të tjera afatshkurtra (shënimi 25 dhe 19)	(574,001)	(169,483)	(187,916)	(216,601)
Ekspozimi neto	50,297,182	50,382,515	328,616	(413,948)
Detyrime jashtë bilancit	-	-	-	-
Ekspozimi neto në dhe jashtë bilancit	50,297,182	50,382,515	328,616	(413,948)

Kurset kryesore të këmbimit të përdorura gjatë vitit:

Në Lekë	Kursi mesatar		Kursi në datën e raportimit	
	2019	2018	2019	2018
USD 1	109.8575	107.9845	108.640	107.82
EURO 1	123.0148	127.2509	121.77	123.39

Tabela e mëposhtme paraqet ndjeshmërinë e fitim/humbjes ndaj ndryshimeve të arsyeshme dhe të mundshme të kurseve të këmbimit në fund të periudhës raportuese në krahasim me monedhën funksionale të Shoqërisë, duke mbajtur konstantë faktorët e tjerë.

	Fitim ose humbje	
	Forcim	Dobësim
31 Dhjetor 2019		
EURO (lëvizje me 5%)	(266,268)	266,268
USD (lëvizje me 5%)	(12,310)	12,310
31 Dhjetor 2018		
EURO (lëvizje me 5%)	2,519,126	(2,519,126)
USD (lëvizje me 5%)	16,431	(16,431)

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE- 31 DHJETOR 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

27. Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

	Fitim ose humbje	
	Forcim	Dobësim
31 Dhjetor 2019		
EURO (lëvizje me 10%)	(532,536)	532,536
USD (lëvizje me 10%)	(24,620)	24,620
31 Dhjetor 2018		
EURO (lëvizje me 10%)	5,038,252	(5,038,252)
USD (lëvizje me 10%)	32,862	(32,862)

Rreziku i normës së interesit. Shoqëria është e ekspozuar ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet mbizotëruese të normave të interesit të tregut në pozicionin e saj financiar dhe flukset monetare. Marzhet e interesit mund të rriten si rezultat i ndryshimeve të tilla, por mund të zvogëlojnë ose krijojnë humbje në rast se linden lëvizje të papritura. Drejtimi monitoron çdo ditë dhe vendos kufij në nivelin e mospërputhjes së riblerjes së normës së interesit që mund të ndërmerret. Tabela më poshtë përmbledh ekspozimin e Shoqërisë ndaj rreziqeve të normës së interesit. Tabela paraqet vlerat kontabël të grumbulluara të aktiveve dhe detyrimeve financiare të Shoqërisë, të kategorizuara sipas ripërcaktimit të mëhershëm të interesit kontraktual ose datës së maturimit:

	Pa afat ose më pak se 1 muaj	1 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
31 dhjetor 2019					
Totali i aktiveve financiare	2,731,132	-	-	-	2,731,132
Totali i detyrimeve financiare	(5,736,357)	-	-	-	(5,736,357)
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në bilanc më 31 dhjetor 2019, neto	(3,005,225)	-	-	-	(3,005,225)
Detyrime jashtë bilancit	-	-	-	(4,654,049)	(4,654,049)
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në dhe jashtë bilancit	(3,005,225)	-	-	(4,654,049)	(7,659,274)

	Pa afat ose më pak se 1 muaj	1 deri 6 muaj	6 deri 12 muaj	Mbi 1 vit	Totali
31 dhjetor 2018					
Totali i aktiveve financiare	55,531,429	-	-	-	55,531,429
Totali i detyrimeve financiare	(5,235,420)	-	-	-	(5,235,420)
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit në bilanc më 31 dhjetor 2018, neto	50,296,009	-	-	-	50,296,009

Një rritje / (ulje) prej 5% e normës së interesit në datën e raportimit do të kishte zvogëluar / (rritur) kapitalin neto dhe fitimin neto me 127,722 mijë lekë (2018: rritur / (ulur) 2,137,522 mijë lekë).

Një rritje / (ulje) prej 10% e normës së interesit në datën e raportimit do të kishte zvogëluar / (rritur) kapitalin neto dhe fitimin neto me 255,444 mijë lekë (2018: rritur / (zbritur) 4,275,044 mijë lekë).

Rreziqe të tjera të çmimit. Shoqëria nuk ka ekspozim ndaj rrezikut të çmimit të kapitalit.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

28. Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Shoqërisë për menaxhimin e kapitalit janë të mbrojnë aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë në mënyrë që të sigurojë kthimin për aksionarët dhe përfitimet për palët e tjera të interesit dhe për të ruajtur një strukturë optimale të kapitalit për të ulur koston e kapitalit. Për të ruajtur ose rregulluar strukturën e kapitalit, Shoqëria mund të rregullojë shumën e dividendëve të paguar ndaj aksionarëve, të kthejë kapitalin tek aksionarët, të lëshojë aksione të reja ose të shesë aktive për të ulur borxhin.

Shoqëria ka përmbushur të gjitha kërkesat e kapitalit si detyrim i jashtëm përgjatë gjithë vitit 2019 dhe 2018.

Sipas kërkesave të marrëveshjes së përbashkët të huasë (Shënimi 30), Shoqërisë i kërkohet të mbajë raportin e levës financiare të paktën 1x përgjatë periudhës së kredisë (aktivet neto / huatë).

29. Vlera e drejtë

Matjet e vlerës së drejtë analizohen sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë si vijon: (i) niveli i parë janë matjet me çmime të kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike, (ii) matjet e nivelit të dytë janë teknikat e vlerësimit me të gjitha inputet materiale (iii) matjet e nivelit të tretë janë vlerësime që nuk bazohen në të dhënat e vëzhgueshme të tregut (inputet e pa vëzhgueshme). Drejtimi aplikon gjykimin për kategorizimin e instrumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse një matje e vlerës së drejtë përdor te dhëna të vëzhgueshme që kërkojnë rregullim të rëndësishëm, kjo matje është një matje e Nivelit 3. Rëndësia e një inputi të vlerësimit vlerësohet në matjen e vlerës së drejtë në tërësinë e saj.

a) Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë

Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ato që standardet e kontabilitetit kërkojnë ose lejojnë në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportimi.

Ndërtesat administrative vlerësohen për vlerën e tyre në treg nga Encon Consulting Albania, një shoqëri vlerësuese e specializuar në vlerësimin e pasurive të patundshme. Shikoni Shënimin 12 për më shumë detaje.

Sistemet dhe rrjetet e telekomunikacionit që janë blerë kohët e fundit dhe janë vendosur në përdorim për të zëvendësuar sistemet ekzistuese më të vjetra, vlerësohen nga Shoqëria duke iu referuar çmimeve të fundit të ofruara nga ofruesit e mundshëm në një proces tenderi konkurrues. Mesatarja e tenderave për secilin nga projektet e paraqitura është konsideruar si vlera e tregut të projektit, pavarësisht nga vlera fituese e rënë dakord. Diferenca midis mesatares së ofertave dhe vlerës së fituesit është konsideruar si shuma e rivlerësimit që i shtohet vlerës së blerjes së aktiveve. Referojuni Shënimin 12 për më shumë detaje. Teknika e vlerësimit, inputet e përdorura në matjen e vlerës së drejtë për matjet e nivelit 3 dhe ndjeshmëria e lidhur me ndryshimet e mundshme dhe në mënyrë të arsyeshme në ato inpute më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	Vlera e drejtë	Teknika e vlerësimit	Inputet e përdorur	Ndryshim i arsyeshëm	Ndjeshmëria në matjen e vlerës së drejtë
Aktive me vlerë të drejtë					
Aktive jo-financiare					
- Ndërtesa administrative	433,829	Metoda direkte dhe metoda e kapitalitimit të ardhurave	Fuqia blerëse	3%	13,015
- Përmirësimet e simeve të rrjetit	1,314,292	Çmimi ofertë nga një pale e vullnetshme dhe jo e lidhur në ankand	Fuqia blerëse	3%	39,429
Totali i matjeve të përsëritura të vlerës së drejtë të nivelit 3	1,748,121				52,444

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE- 31 DHJETOR 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

29. Vlera e drejtë (vazhdim)

Ndryshimet në fuqinë blerëse maten në bazë të nivelit të inflacionit, normës në të cilën niveli i përgjithshëm i çmimeve për mallra dhe shërbime po rritet dhe rrjedhimisht, fuqia blerëse e monedhës po bie.

Qeveritë shpesh përpiqen për një normë inflacioni prej rreth 2 deri në 3 përqind në vit. Një inflacion i tillë i ulët është i dobishëm dhe inkurajon konsumatorët të blejnë mallra dhe shërbime. Ndjeshmëria e matjeve të vlerës së drejtë sipas shënimeve shpjeguese në tabelën e mësipërme tregon drejtimin që do të kishte një rritje ose rënie e variablave përkatëse të hyrjes në rezultatin e vlerësimit. Për ndërtesat administrative dhe të rrjetit, rritja e nivelit të inflacionit me 3% do të çonte në një rritje të vlerës së vlerësuar me 52,444 mijë lekë.

(c) Proceset e vlerësimit për matjet e përsëritura dhe jo të përsëritura të vlerës së drejtë, niveli 3

Vlerësimet e nivelit 3 rishikohen çdo muaj nga Drejtori i Financës së Shoqërisë i cili raporton Drejtorit Ekzekutiv dhe Bordit Mbikëqyrës. Drejtori i Financës konsideron se sa të përshtatshme janë inputet e modelit të vlerësimit, si dhe rezultatin e vlerësimit duke përdorur metoda dhe teknika të ndryshme vlerësimi. Në zgjedhjen e modelit më të përshtatshëm të vlerësimit, drejtori kryen teste duke u kthyer në kohë dhe konsideron se cilat rezultate të modelit historikisht janë lidhur më ngushtë me transaksionet aktuale të tregut. Referojuni shënimit 3 për inputet e përdorura në matjen e vlerës së drejtë të Nivelit 3.

(d) Aktivet dhe detyrimet që nuk maten me vlerën e drejtë, por për të cilat vlera e drejtë jepet si informacion shpjegues

Vlerat e drejta të analizuara sipas nivelit në hierarkinë e vlerës së drejtë dhe vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve që nuk maten me vlerën e drejtë janë si më poshtë: Aktivet financiare.

	31 Dhjetor 2019				31 Dhjetor 2018			
	Vlera e drejtë niveli 1	Vlera e drejtë niveli 2	Vlera e drejtë niveli 3	Vlera kontabël	Vlera e drejtë niveli 1	Vlera e drejtë niveli 2	Vlera e drejtë niveli 3	Vlera kontabël
AKTIVE								
Llogari të arkëtueshme	-	-	795,792	795,792	-	-	1,763,561	1,763,561
Të arkëtueshme nga qiraja financiare	-	-	34,326	34,326	-	-	-	-
Huadhënie	-	-	-	-	-	-	42,277,030	42,277,030
Mjete monetare dhe ekuivalenë të tyre	-	1,901,014	-	1,901,014	-	11,490,839	-	11,490,839
TOTALI I AKTIVEVE	-	1,901,014	830,118	2,731,132	-	11,490,839	44,040,591	55,531,430

	31 Dhjetor 2019				31 Dhjetor 2018			
	Vlera e drejtë niveli 1	Vlera e drejtë niveli 2	Vlera e drejtë niveli 3	Vlera kontabël	Vlera e drejtë niveli 1	Vlera e drejtë niveli 2	Vlera e drejtë niveli 3	Vlera kontabël
DETYRIME								
- Detyrime të qirasë financiare			1,037,200	1,037,200			3,803	3,803
- Llogari të pagueshme			3,848,338	3,848,338			4,656,443	4,656,443
- Dividend për tu paguar			9,465	9,465			261	261
- Detyrime të tjera të përlloraritura			664,411	664,411			573,740	573,740
TOTAL LIABILITIES			5,559,414	5,559,414			5,234,247	5,234,247

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare të mësipërme dhe aktiveve jo-financiare që nuk janë kuotuar në një treg aktiv vlerësohet të ishte e barabartë me vlerën e tyre kontabël.

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

30. Balanca dhe transaksione me palët e lidhura

Palët konsiderohen të lidhura nëse janë nën kontroll të përbashkët ose nëse njëra palë ka aftësinë të kontrollojë palën tjetër ose mund të ushtrojë influencë të konsiderueshme ose kontroll të përbashkët mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare dhe operative. Në shqyrtimin e secilës marrëdhënie të mundshme të palëve të lidhura, vëmendja shkon ndaj përmbajtjes së marrëdhënies, jo thjesht formës juridike.

Që nga 31 dhjetori 2018, shoqëria mëmë përfundimtare e Shoqërisë ishte Deutsche Telecom AG ("DTAG"), Bon, Gjermani. Pas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, më 22 prill 2019, më 7 maj 2019 pronësia e 99.9% të aksioneve u transferua zyrtarisht dhe plotësisht nga Cosmote Telecommunications SA në Albanian Telekom Invest AD. Si rrjedhojë, shoqëria mëmë përfundimtare është Albanian Telekom Invest AD, një shoqëri e vendosur në Bullgari. Aksionarët e saj janë Z. Spas Rusev i cili zotëron 65% të aksioneve dhe Z. Elvin Guri me 35%. Z.Spas Rusev është pala përfundimtare kontrolluese e grupit.

Për shkak të ndryshimit të pronësisë së Shoqërisë, transaksionet me palët e lidhura paraqiten në dy seksione të veçanta.

Transaksionet dhe balancat me shoqëritë e lidhura pas ndryshimit të pronësisë

Pas blerjes së shumicës së aksioneve të zakonshme të Shoqërisë nga Albanian Telekom Invest AD (shënimi 1), Shoqëria nënshkroi një marrëveshje të përbashkët huaje mes tre palëve, me shoqërinë mëmë përfundimtare (ATI) dhe First Investment Bank (FIB) Bullgari. Sipas marrëveshjes së përbashkët të huasë, Shoqëria u bë një bashkëkredimarrës në marrëveshjen e financimit ku ATI mori një kredi prej 48.5 milion Euro nga FIB Bullgari. Huatë dhe huamarrjet kanë një normë interesi prej 5% nga të cilat 2% përfundojnë së bashku me principalin më 10 maj 2029 dhe 3% janë të pagueshme në bazë vjetore. Në maj të vitit 2019, Telekom pagoi 10 milion Euro (vetëm për principalin) duke shtuar gjithashtu këste mujore në Bankë në emër të ATI.

Sipas marrëveshjes së përbashkët të huasë të datës 9 maj 2019, Shoqëria ka të njëjtat detyrime ndaj FIB Bullgaria ashtu si dhe ATI. Të gjitha aktivet jo-financiare afatgjata si dhe aktivet neto të Shoqërisë janë vendosur si kolateral kundrejt marrëveshjes. Këstet paguhen nga Shoqëria dhe treguesit kryesorë të performancës në lidhje me marrëveshjen bazohen në pozicionin financiar të Shoqërisë, performancën dhe flukset e mjeteve monetare.

Pagesat e huasë nga ATI shlyhen nga Shoqëria dhe të arkëtueshmet nga ATI të lidhura me huanë më pas kompensohen ndaj dividendit të pagueshëm. Bazuar në marrëveshjen e datës 9 dhjetor 2019 midis Shoqërisë dhe ATI, dividendi i pagueshëm ndaj ATI është kompensuar ndaj të arkëtueshmeve nga ATI për shlyerjet e kredisë (referojuni Shënimit21).

	31 Dhjetor 2019	Maj 2019
Detyrime nga palët e lidhura:		
Bulgarian Telecommunications Company EAD	41,882	-
	<u>41,882</u>	<u>-</u>
	31 Dhjetor 2019	Maj 2019
Detyrime ndaj palëve të lidhura:		
Bulgarian Telecommunications Company EAD	100	-
	<u>100</u>	<u>-</u>

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE- 31 DHJETOR 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

30. Balanca dhe transaksione me palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me shoqëritë e lidhura përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2019
Të ardhura:	
Shitja e mallrave	41,658
Të ardhura nga interesi	44,841
Roaming	167
Të tjera	231
	<u>86,897</u>

	31 Dhjetor 2019
Shpenzime:	
Shpenzime konsulence dhe shërbime të tjera mbështetëse (Cross charges)	3,166
Shpenzime interesash	13,556
Roaming	47
Të tjera	230
	<u>16,999</u>

Shpërblimi i personelit kryesor të drejtimit

Pagesa totale, tarifa të tjera për drejtorët dhe zyrtarët kryesorë pas 7 maj 2019 dhe kostoja e përfitimeve të bazuara në aksione përfshihen në shpenzimet e personelit:

	31 Dhjetor 2019
<u>Shpenzime personeli</u>	
Drejtorët e Bordit Mbikëqyrës	12,043
Bordi i Drejtorëve	43,140
Sigurimet shoqërore	1,009
Pagesa të bazuara në aksione	
Totali	<u>56,192</u>

Shpërblimi i personelit kryesor të drejtimit përfshin shpenzimet që vijnë nga marrëveshjet e qirasë në të cilat Shoqëria ka hyrë për të përdorur ndërtesa për strehimin e drejtimit.

Transaksionet dhe balancat me shoqëritë e lidhura para ndryshimit të pronësisë

Balancat e llogarisë me Cosmote dhe me shoqëri të tjera të lidhura, hyrje nën kontrollin e përbashkët të shoqërisë mëmë përfundimtare, janë si më poshtë.

	30 Prill 2019	31 Dhjetor 2018
Detyrime nga:		
COSMOTE (obligacion)	-	27,886,018
COSMOTE (interes i përlogaritur)	-	87,481
	<u>-</u>	<u>27,973,499</u>
OTE Globe	89,074	126,637
T-Mobile Crna Gora d.o.o.	85,223	85,912
Cosmote	40,613	32,879
T-Mobile USA Inc.	1,263	2,085
DT MNG Fee	-	6,237
Të tjera pale të lidhura	18,007	11,117
	<u>234,180</u>	<u>264,867</u>

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE- 31 DHJETOR 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

30. Balanca dhe transaksione me palët e lidhura (vazhdim)

Të arkëtueshme afatgjata:

OTE S.A (obligacion)	-	14,189,788
OTE S.A (interes i përlogaritur)	-	113,742
	-	<u>14,303,530</u>

Obligacione

Shoqëria ka blerë obligacione nga OTE S.A dhe Cosmote S.A në vlerën 341,000 mijë Euro (42,075,806 mijë lekë) gjatë periudhës së mbyllur më 31 dhjetor 2018 (2017: 130,000 mijë Euro (17,281,948 mijë lekë)). Vlera e obligacioneve të mbajtura me kosto të amortizuar prej 14,303,530 mijë lekë, e klasifikuar si afatgjatë dhe vlera prej 27,973,499 mijë lekë e klasifikuar si afatshkurtër në datën e raportimit, u ripaguan plotësisht më 20 janar 2019 dhe 23 Prill 2019 mbi vlerën nominale dhe atë kontabël.

Norma mesatare e interesit efektiv i zbatueshëm për 2018 ishte 1.3767% p.a. (2017: 2.2135%).

	30 Prill 2019	31 Dhjetor 2018
Vlera e kuponit	-	42,731,331
Zbritja	-	(655,525)
	-	<u>42,075,806</u>
Amortizimi në fund të vitit	-	201,223
	-	<u>42,277,029</u>

Obligacione në Cosmote më 31 Dhjetor 2018

Data e kontratës	Data e blerjes	Data e maturimit	Kosto në Euro '000	Vlera e kuponit në Euro '000	Zbritja në Euro '000	Në lekë '000
04.05.2017	05.05.2017	05.11.2019	5,126	5,000	126	616,947
15.01.2018	16.01.2018	10.01.2019	20,203	20,000	203	2,467,789
04.09.2018	05.09.2018	29.08.2018	100,738	100,000	738	12,338,946
04.09.2018	05.09.2018	05.09.2018	101,768	101,000	768	12,462,335
Totali më 31 Dhjetor 2018			227,835	226,000	1835	27,886,017

Obligacione në Cosmote më 31 Dhjetor 2018

Data e kontratës	Data e blerjes	Data e maturimit	Kosto në Euro '000	Vlera e kuponit në Euro '000	Zbritja në Euro '000	Në lekë '000
19.06.2018	19.06.2018	27.05.2020	56,574	55,000	1,574	6,786,420
19.06.2018	19.06.2018	10.06.2020	61,791	60,000	1,791	7,403,368
Total			118,365	115,000	3,365	14,189,788
Totali më 31 Dhjetor 2018			346,200	341,000	5,200	42,075,805

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE- 31 DHJETOR 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

30. Balanca dhe transaksione me palët e lidhura (vazhdim)

Detyrime ndaj palëve të lidhura:

	30 Prill 2019	31 Dhjetor 2018
Detyrime ndaj palëve të lidhura		
Cosmote	270,020	624,728
DTAGEU	113,497	75,312
Deutsche Telekom AG, Europe	42,009	44,001
Ote Globe	19,883	30,020
Të tjera pale të lidhura	13,145	13,058
T-Mobile USA Inc.	13,007	12,600
T-Mobile Crna Gorad.o.o.	11,082	10,718
Magyar Telekom Plc.	8,125	14,250
BK T-Systems International GmbH (TelIT)	7,498	10,223
T-Mobile Macedonia AD Skopje	6,652	6,008
Telekom Deutschland GMBH	6,276	4,459
T-Mobile Deutschland GmbH	2,164	2,278
DT MNG Fee	347	6,037
OTE	314	7,771
	514,018	861,463

Transaksionet me shoqëritë e lidhura përbeheshin si më poshtë:

	30 Prill 2019	31 Dhjetor 2018
<u>Të ardhura</u>		
Shërbime interkonjeksionis	190,168	677,160
Të ardhura nga interesi	324,585	500,383
Linja të marra me qira	15,074	168,363
Roaming dhe SMS interworking	4,121	19,508
Të tjera	3,080	9,283
	537,028	1,374,697
<u>Shpenzime</u>		
Shërbimet teknike, drejtuese dhe shërbime të tjera mbështetëse	275,504	596,337
Shërbime interkonjeksioni	35,924	170,770
Roaming dhe SMS interworking	19,182	67,552
Linja të marra me qira	2,190	5,526
Të tjera	15,261	16,437
Totali	348,061	856,622

	30 Prill 2019	31 Dhjetor 2018
<u>Shpenzime kapitale</u>		
Shpenzimi i pajisjeve të blera (shënimi 12)	53,697	16,095

Shoqëria mban një numër lidhjesh tregtare dhe marrëveshesh me Cosmote-në të cilat lidhen kryesisht me:

- (i) Marrëveshje për shërbime konsulence që lidhen me përgatitjen, instalimin dhe funksionimin e rrjetit të Shoqërisë, për aktivitetin tregtar si dhe aktivitetin e saj të përditshëm;
- (ii) Mbështetje teknike dhe drejtuese dhënë nga Cosmote;
- (iii) Marrëveshja e interkonjeksionit me Cosmote dhe OTE Globe;
- (iv) Marrëveshje shërbimi për kapacitet rrjeti dhe linjash me OTE Globe (përfshirë në shënimin 22).

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE- 31 DHJETOR 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

30. Balanca dhe transaksione me palët e lidhura (vazhdim)

Transaksionet me Cosmote (përfshirë në totalët e mësipërme) përbëhen si më poshtë:

	30 Prill 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime		
Shërbime teknike, drejtuese dhe shërbime të tjera mbështetëse	152,809	481,467
Shërbime interkonjeksiioni	9,951	0
Mirëmbajtja e programeve kompjuterike	4,566	20,130
Roaming	5,706	33,957
Total	173,032	535,554

	30 Prill 2019	31 Dhjetor 2018
Të ardhura		
Shërbime Interkonjeksiioni	40,366	227,848
Të ardhura nga interesi	71,054	174,248
Roaming	1,040	3,959
Total	112,460	406,055

Shpërblimi i personelit kryesor të drejtimit

Pagesa totale, tarifa të tjera për drejtorët dhe zyrtarët kryesorë para dates 7 maj 2019 dhe kostoja e përfitimeve të bazuara në aksione përfshihen në shpenzimet e personelit:

	30 Prill 2019	31 Dhjetor 2018
Shpenzime personeli		
Drejtorët e Bordit Mbikëqyrës	1,272	3,138
Bordi i Drejtorëve	353,952	157,294
Sigurimet shoqërore	827	2,721
Pagesa të bazuara në aksione	277	789
Total	356,328	163,942

Shpërblimi i personelit kryesor të drejtimit përfshin shpenzimet që vijnë nga marrëveshjet e qirasë në të cilat Shoqëria ka hyrë për të përdorur ndërtesa për strehimin e drejtimit. (referojuni shënimit 15).

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë lekë, përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)

31. Angazhime dhe aktive / detyrime të kushtëzuara

(i) Angazhime të qirasë operative

Në rastet kur Shoqëria ka qenë qiramarrëse, pagesat minimale të ardhshme të qirasë sipas qirave operative të pa-anullueshme më 31 Dhjetor 2018 ishin si më poshtë:

	31 Dhjetor 2018
Brenda një viti	181,202
Pas një viti por jo më shumë se pesë vjet	487,421
Më shumë se pesë vjet	247,711
	<u>916,334</u>

(ii) Roaming ndërkombëtar

Më 31 dhjetor 2019, Shoqëria ka hyrë në marrëveshje ndërkombëtare roaming me 392 operatorë GSM 900, 1800, 1900, 3G, 4G në 160 vende (2018: 160 vende). Këto marrëveshje parashikojnë që kur një abonenti i Shoqërisë përdor shërbimin e një operatori korrespondent në një vend tjetër, Shoqëria është përgjegjëse për pagesën e tarifave për këto shërbime në përputhje me tarifat përkatëse të operatorit ndërkombëtar përkatës (TON). Shoqëria i transferon këto tarifa tek klientët përkatës bashkë me një çmim shtesë. Në mënyrë të ngjashme, kur një operator i një shoqërie tjetër korrespondente përdor rrjetin e Shoqërisë, ajo i faturon tarifat për shërbimin operatorit përkatës sipas tarifave të operatorit ndërkombëtar të shoqërisë (TON).

(iii) Çështje gjyqësore dhe pretendime

Në rrjedhën normale të biznesit, Shoqëria është e përfshirë në procese gjyqësore me palët e tjera. Në bazë të vlerësimeve të veta dhe këshilla profesionale si të brendshme ashtu edhe të jashtme, Drejtimi është i mendimit se nuk do të ketë humbje materiale në lidhje me pretendimet që tejkalojnë rezervat që janë bërë në këto pasqyra financiare.

A. Kushtëzime tatimore

Inspektimi për tatim fitimin për 2011 – 2012 dhe inspektimi i TVSH-së për 2011 - 2013

Pas përfundimit të inspektimit të tatimit mbi fitimin për 2011 dhe 2012 dhe të TVSH-së për periudhën 11/2011 - 08/2013, raporti përfundimtar i kontrollit tatimor përfshinte një penalitet të përgjithshëm prej 218,309 mijë lekë dhe shumica e tij përbëhet nga penaliteti mbi faturat e shitjeve të kartave SIM të parapaguara të cilat janë konsideruar si jo të plota nga Autoriteti tatimor, pasi nuk ndanin vlerën e kartës SIM nga vlera fillestare nga momenti i aktivizimit. Shoqëria lëshon ndaj klientit një faturë të vetme për totalin e vlerës së shitur. Në bazë të vendimit të Drejtorisë së Apelit, shumica e penaliteteve është zvogëluar në 158,320 mijë lekë. Telekom paraqiti një kërkesë në gjykatë më 15 prill 2016, duke kërkuar anulimin e njoftimit të vlerësimit tatimor.

Më 30 janar 2017, gjykata e anuloi kërkesën e Telekom. Telekom Albania ka apeluar kundër këtij vendimi para Gjykatës së Apelit Administrativ. Kjo gjykatë shqyrtoi çështjen në dhomën e këshillimit (pa praninë e palëve) më 13 nëntor 2018 dhe vendosi të ndryshojë pjesërisht vendimin e gjykatës administrative Tiranë, si më poshtë:

- Shfuqizimi i pjesës vlerësimin tatimor për sa i përket TVSH-së dhe detyrimeve të tatimit mbi fitimin në lidhje me mos njohjen e borxheve të këqija, konkretisht: detyrimin e TVSH-së prej 5,126,004 lekë; penalitetin e TVSH prej 817,125 lekë; detyrimin e tatimit mbi fitimin prej 1,633,322 lekë dhe penalitetin e tatimit mbi fitimin 408.330 lekë;

- Të mbështesë vendimin e Gjykatës Administrative të Tiranës për të gjitha pretendimet e tjera.

Në seancën dëgjimore të 27 qershorit 2019, Gjykata e Apelit Administrativ vendosi të ndryshojë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke anuluar Njoftimin për Detyrimet Tatimore nr 6280/8 prot, datë 17.11.2015 dhe vendimin nr. 41675/4 (41314) prot., Datë 15.03.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

31. Angazhime dhe aktive / detyrime të kushtëzuara (vazhdim)

Autoritetet tatimore dhe Telekom kanë paraqitur rekurs në gjykatën supreme. Sidoqoftë, pavarësisht argumenteve të mira, ende nuk ka siguri që Gjykata Supreme do të marrë mendimin tonë, pasi shpesh vërehet në praktikën tonë, tendenca e gjykatave për të vendosur në favor të autoriteteve tatimore në çështjet gjyqësore tatimore. Duke patur parasysh këto pasiguri, kushtet për njohjen e aktivitetit nuk janë përmbushur ende pasi çështja tani është në pritje në gjykatën supreme.

B. Çështje të tjera gjyqësore

Shoqëria është subjekt i proceseve të tjera ligjore, pretendimeve dhe mosmarrëveshjeve që lindin gjatë rrjedhës normale të biznesit. Drejtimi beson se kostot e nevojshme për zgjidhjen e këtyre çështjeve nuk do të kenë efekt material në pozicionin financiar të shoqërisë, rezultatet e veprimtarisë apo flukset monetare.

C. Aktive të vendosura si kolateral ose të kufizuara

Më 31 dhjetor 2019, të gjitha aktivet neto të Shoqërisë janë vendosur si kolateral për marrëveshjen e huasë së përbashkët me FIB Bullgari dhe ATI (Shënimi 30).

D. Pajtueshmëria e marrëveshjeve

Shoqëria i nënshtrohet disa marrëveshjeve që lidhen kryesisht me huatë e ATI. Mosrespektimi i këtyre marrëveshjeve mund të rezultojë në pasoja negative për Shoqërinë, duke përfshirë rritjen e kostos së huasë dhe deklarimin e dështimit. Shoqëria ishte në përputhje me kushtet e marrëveshjes në 31 dhjetor 2019.

32. Ngjarje pas datës së raportimit

Përhapja e COVID-19 është zhvilluar me shpejtësi në vitin 2020, me një numër të konsiderueshëm infeksionesh.

Në fund të vitit një numër i limituar rastesh me një virus të panjour është raportuar në Organizatën Botërore të Shëndetësisë ("OBSH"). Përhapja e mëpasshme e virusit dhe identifikimi i tij si COVID-19 nuk ofron dëshmi shtesë në lidhje me situatën që ka ekzistuar më 31 dhjetor 2019 dhe për këtë arsye konsiderohet si një ngjarje jo rregulluese. Sidoqoftë, më 11 mars 2020, OBSH e shpalli COVID-19 një pandemi. Qeveria shqiptare ka ndërmarrë gjithashtu masa kufizuese në përpjekje për të mbajtur nën kontroll përhapjen. Që nga fillimi i marsit, shkollat dhe aktivitetet e bizneseve janë të mbyllura përveç atyre që kanë një natyrë thelbësore. Udhëtimi ajror si dhe transporti tokësor nuk janë më në dispozicion për qëllime private. Të gjitha kufijtë janë të mbyllura dhe udhëtimi ndër-urban është i ndaluar. Bankave u është kërkuar të sigurojnë pezullime të pagesave për huamarrësit e tyre në vështirësi financiare për shkak të pandemisë, ndërsa qiramarrësve u lejohet të shtyjnë pagesën e qirasë për prill dhe maj 2020. Shumë punonjës jo thelbësorë në të gjithë vendin janë ose duke punuar nga shtëpia ose nuk punojnë gjatë kësaj periudhe .

Këto masa kanë ndikime të konsiderueshme në mjedisin ekonomik në Shqipëri duke rezultuar në çështje të likuiditetit, rënie të përgjithshme të kërkesës për mallra dhe shërbime në të gjithë vendin. Si rezultat, menaxhimi i likuiditetit të Shoqërisë është nën presion ndërsa cilësia e kredisë së aktiveve të saj financiare mund të ndikohet negativisht.

Në këto rrethana, Shoqëria vazhdon të operojë duke iu përshtatur masave të vendosura. Planet e krizës janë ekzekutuar duke ndihmuar klientët të hyjnë në dyqanet me pakicë brenda orëve të kufizuara siç lejohet nga udhëzimet e qeverisë. Për më tepër, për shkak të një transformimi të rëndësishëm dixhital që Shoqëria ka realizuar gjatë vitit 2019, punonjësit kryesisht punojnë nga shtëpia me kohë fleksibël pune, duke plotësuar nevojat e shoqërisë dhe kërkesat e klientit. Stafit i shitjeve dhe teknologjisë janë në shërbim të klientëve çdo ditë, duke ndjekur në mënyrë rigoroz rregullat e qeverisë për situatën e pandemisë. Të ardhurat totale janë në nivelet e vitit 2019 dhe pritshmëritë e drejtimit se do të ketë një rritje të vogël pasi operacionet të kthehen në normalitet. Gjatë vitit 2019 e më pas, strategjia tregtare e Shoqërisë ka qenë të zhvillojë dhe vërë në funksion kanale të ndryshme.

32. Ngjarje pas datës së raportimit (vazhdim)

Situata ka një efekt pozitiv në planet e Shoqërisë pasi shpejton shumicën e nismave që ndikojnë në përsosmërinë operacionale dhe krijimin e kanaleve të reja të shitjeve të tilla si telemarketing, shitje në internet, dyqane ushqimore në treg masiv, sende ushqimore dhe shpërndarje në shtëpi.

Ndërsa nuk mund të bëhet një vlerësim i ndikimit të COVID-19 në pasqyrat financiare për fundvit, ndikimi i krizës do të jetë domethënës dhe negativ në nivelin makro-ekonomik, ashtu si dhe mbi Shoqërinë, duke u vendur në vështirësi mbi vëllimin e shitjeve, rrezikun e kredisë, administrimin e likuiditetit dhe respektimin e marrëveshjeve.

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që do të kërkojnë rregullime ose shënime shpjeguese shtesë në këto pasqyra financiare.

33. Politika kontabël përpara dates 1 janar 2019

Politikat e kontabilitetit të zbatueshme për periudhën krahasuese të mbyllur më 31 dhjetor 2018 që u ndryshuan nga SNRF 16, Qiratë, janë si më poshtë.

Qiratë operative. Kur Shoqëria është një qiramarrëse në një qira e cila nuk transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet rastësore nga qiramarrësi të Shoqëria, totali i pagesave të qirasë njihen në fitim ose humbje të vitit në baza lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Afati i qirasë është një periudhë e paanullueshme për të cilën qiramarrësi ka hyrë në një kontratë për të marrë me qira aktivin duke përfshirë edhe kushtet nga të cilat qiramarrësi ka opsionin të vazhdojë qiranë, me ose pa pagesa të mëtejshme, kur ka siguri të arsyeshme në fillim të qirasë se qiramarrësi do ta ushtrojë atë të drejtë.

Detyrimet e qirasë financiare. Kur Shoqëria është qiramarrëse në një qira e cila transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe shpërblimet rastësore nga qiramarrësi të Shoqëria, aktivet e marra me qira kapitalizohen në aktive afatgjata materiale në fillim të qirasë në vlerën më të ulët mes vlerës së drejtë të aktivit me qira dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë. Çdo pagesë qiraje qëndron midis detyrimit dhe tarifave financiare në mënyrë për të arritur një normë konstante për balancën e mbetur. Detyrimet përkatëse të qirasë, neto nga tarifat e ardhëshme financiare, përfshihen në huamarrje. Shpenzimi i interesave njihet në fitim ose humbje përgjatë periudhës së qirasë duke përdorur metodën e interesit efektiv. Aktivet nga qiraja financiare amortizohen me jetën e tyre të dobishme ose me afatin e qirasë, nëse Shoqëria nuk ka siguri të arsyeshme se do të ketë pronësi në fund të afatit të qirasë.

TELEKOM ALBANIA SH.A.

Fitimi para interesave, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit, i rregulluar (EBITDA)

Fitimi para interesave, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit, i rregulluar (EBITDA)

Komiteti drejtues kryesisht përdor një masë të fitimeve të rregulluara para interesit, tatimeve, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA, si më poshtë) për të vlerësuar ecurinë e aktiviteteve të Shoqërisë.

EBITDA përjashton efektet e zërave të rëndësishëm të të ardhurave dhe shpenzimeve të cilat mund të kenë ndikim në cilësinë e fitimeve siç janë shpenzimet e ristrukturimit, shpenzimet ligjore dhe zhvlerësimet në rastin kur zhvlerësimi është rezultat i një ngjarje të izoluar e jo të përsëritur. Gjithashtu përjashtohen efektet e pagesave të bazuara në aksione dhe fitimet ose humbjet e përealizuara në instrumentet financiare.

	Shënim	2019	2018
Fitimi/(humbja) para tatimit		182,979	(4,720,737)
Amortizimi i aktiveve materiale afatgjata	7&8	1,547,174	1,138,166
Zhvlerësimi i aktiveve materiale afatgjata		-	-
Kthimi i zhvlerësimit të aktiveve materiale afatgjata	7&8	(191,607)	-
Amortizimi i aktiveve me të drejtë përdorimi	7&8	316,852	5,117
Amortizimi i aktiveve afatgjata jo-materiale	7&8	522,974	497,328
Shpenzime të tjera	10	487,516	22,269
Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	16	134,819	
Shpenzimet e personelit	8	(119,599)	
Kursi i këmbimit, neto		(177,980)	4,012,684
Shpenzime financiare, neto		(280,307)	(489,207)
Kthimi i zbritjes mbi detyrimin për tërheqjen e aktiveve	7	(133,032)	11,393
EBITDA		2,289,789	477,013